



*Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 7.11.2019, Ora 10.00

**Drejtojnë mbledhjen:**

**Damian Gjikhuri dhe Rudina Hajdari – bashkëkryetarë të Komisionit të  
Posaçëm të Reformës Zgjedhore**

**Rendi i ditës:**

1. Seancë dëgjimore me Aleancën e Grave Parlamentare në lidhje me një propozim për Kodin Zgjedhor
2. Diskutimi i draftit të përpunuar nga ekspertët e Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore

**Marrin pjesë:**

Damian Gjikhuri, Rudina Hajdari, Vasilika Hysi, Klotilda Bushka, Blerina Gjylameti, Alket Hyseni, Bashkim Fino, Arben Elezi, Myslim Murrizi, Nimet Musaj, Korab Lita, Adriatik Alimadhi dhe Adnor Shameti.

**Mungojnë:**

## HAPET MBLEDHJA

**Rudina Hajdari** – Sot kemi ftuar Aleancën e Grave, të cilat kanë kërkuar të dëgjohen në këtë seancë dëgjimore në lidhje me një propozim për Kodin Zgjedhor. Ne jemi plotësisht dakord që t'ju dëgjojmë sot dhe ekspertët janë këtu për t'ju dëgjuar lidhur me propozimet tuaja. Ju kujtoj se lidhur me këtë temë kemi pasur një propozim në draftin e parë, kështu që, nëse do të jetë e nevojshme drafti i parë do të rishikohet, duke marrë parasysh edhe propozimin që do të bëjë Aleanca e Grave.

Kush do ta bëjë dëgjesën?

**Damian Gjikhuri** – Më falni, që po ndërhyj, por dua t'ju them se kjo dëgjesë është për të dëgjuar opinionin tuaj dhe nuk do të shpreheni me propozime.

**Rudina Hajdari** – Mendova se kishim një propozim konkret lidhur me...

**Elona Gjebrea** – Përshëndetje të gjithëve!

Ne kemi ardhur këtu një grup grash deputete, përfaqësuese të Aleancës së Grave Deputete dhe duam të japim disa sugjerime në lidhje me përfshirjen, ose përmirësimin e barazisë së përfaqësimit politik të grave në zgjedhjet parlamentare dhe, pa dyshim, jo vetëm, por edhe një reflektim të përmirësimeve të fundit të Kodit Zgjedhor.

Ne nuk kemi zgjedhur një përfaqësi, sepse jemi të gjitha të lira të japim mendimet tona.

**Rudina Hajdari** – A është prezent kryetarja e Aleancës së Grave?

**Elona Gjebrea** – Jo nuk është, por ne i kemi lajmëruar të gjithë me email, edhe juve si grua deputete, pjesë e Aleancës.

I falënderoj gratë deputete, të cilat janë prezentë...

**Rudina Hajdari** – Më falni, që po ju ndërpres, por dua të di lidhur me opinionin e marrë. A e keni marrë në mënyrë të përbashkët apo...

**Elona Gjebrea** - Zonja Hajdari, ne këtu kemi ardhur me vullnetin tonë si përfaqësuese të grave deputete të Aleancës, kemi marrë variantin e fundit të përmirësuar të Kodit Zgjedhor dhe kemi ardhur të dëgjojmë dhe të japim opinionet tona. Nuk kemi një opinion të shkruar nga të gjitha ne dhe të rënë dakord.

**Rudina Hajdari** –Faleminderit!

**Elona Gjebrea** - Në radhë të parë ne falënderojmë që Kodi garanton parimin e barazisë gjinore, sipas përcaktimeve që jep parimi i legjislacionit në fuqi në Republikën e

Shqipërisë, dhe, pa dyshim, ky përbën një instrument për t'u vlerësuar në konsolidimin e sistemit demokratik. Ne jemi këtu edhe si rrjedhojë e kuotave e një angazhimi politik dhe vullneti politik që gratë dhe vajzat të jenë më të përfaqësuara jo vetëm në sistemin parlamentar, por edhe në sistemin e përfaqësimit vendor. Pa dyshim që pjesëmarrja e grave në përfshirjen prej rreth 50% në sistemin lokal është një arritje, ashtu sikurse edhe përfaqësimi i grave me kuotën 30% në sistemin parlamentar.

Sigurisht që do të donim të kishte edhe disa përmirësime të mëtejshme në nivelin teknik.

Për sa i përket draftit të fundit, sugjerimi mund të jetë që të kemi një pjesëmarrje të grave të barabartë me atë të burrave në administrimin zgjedhor. Pa dyshim edhe pjesa e mosrespektimit të dispozitave të barazisë gjinore, që është e dënueshme, mund të jetë e përforcuar jo vetëm me gjobë, por mund të ketë edhe një masë më të fortë, e cila mund të diskutohet qoftë edhe me formën e një refuzimi.

Për sa i përket renditjes së kandidatëve, barazia gjinore mund të faktorizohet apo avantazhohet në renditjen e kandidatëve, qoftë në rrafsh horizontal apo vertikal. Kjo mund të bëhet jo vetëm në zgjedhjet kombëtare, por edhe në ato vendore.

Ne e vlerësojmë që drafti i dytë i ardhur nga ju ka reflektuar shumë elemente, të cilat kanë të bëjnë me përfaqësimin e barazisë gjinore. Ky draft është shumë më i mirë se ai i mëparshmi, por pa dyshim që kërkon edhe disa përmirësime, të cilat ne, së bashku si Aleancë, mund t'ua sjellim me shkrim drejtuar komisionit tuaj.

Ju faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Zonja Hajdari, meqenëse edhe ju jeni pjesë e Aleancës, në qoftë se mendoni se ne duhet ta maturojmë propozimin tonë si Aleancë, cilido qoftë ai propozim, dhe të vijë në formë të shkruar e të paraqitet pranë komisionit të nderuar, unë besoj se mund të arrijmë në një dakordësi për ta bërë këtë gjë dhe t'i japim më shumë valenca kësaj gjëje, por si fillim mund të them vetëm që e shikoj jo të pamundur, nëse sistemi do të jetë pak a shumë ky që kemi sot, realizmin e një liste nga ana e forcave politike, një burrë një grua, ose një grua një burrë. Skemën e kam shumë të thjeshtë dhe nuk kam ndonjë filozofi të madhe për të treguar, përkundrazi, kjo ka qenë më e vështirë të realizohet në zgjedhjet lokale, në këshillat komunalë apo bashkiakë, sesa në nivelin parlamentar. Kështu që për detajet dhe gjithçka tjetër ne mund të propozojmë për të përmirësuar prezencën e grave në jetën politike. Ne besojmë se do të mund ta realizojmë në bashkëpunim, por sigurisht duke filluar nga ne,

Aleanca, por duke paraqitur një dokument të shkruar, ku ne të dakordësojmë të gjitha lidhur me mënyrën sesi mund të përfaqësohemi më mirë në jetën parlamentare shqiptare.

Faleminderit!

**Rudina Hajkdari-** Po, zonja Hysi.

A keni pyetje?

**Vasilika Hysi-** Unë nuk kam pyetje, por dua të falënderoj koleget e nderuara deputete, të cilat kanë treguar një vëmendje ndaj propozimeve të hartuara nga ekspertët e komisionit të reformës zgjedhore. Meqenëse unë dhe zoti Nimet duhet të jemi të vëmendshëm për të reflektuar të gjitha komentet që do të vijnë jo vetëm nga gratë deputete, por edhe nga përfaqësuesit e shoqërisë civile lidhur me kuotat gjinore, do ta vlerësoja shumë që të kishim edhe një material me shkrim për momentet konkrete.

Me të drejtë e tha kolegja Gjebrea që drafti ka përmirësim, sepse nuk flasim për jo më pak se 30% të listës, por përbërjes reale të Kuvendit të Shqipërisë. Pra, ka ndryshuar edhe fjala, sepse flitet përbërje reale dhe jo thjesht në lista.

Unë i mirëpres të gjitha sugjerimet konkrete dhe besoj se kemi kohë, të nderuar bashkëkryetarë, për t'u dhënë mundësi përfaqësuesve të Aleancës së Grave, ku jemi edhe ne, që jemi në komision, pjesë e saj, për të diskutuar dhe dakordësuar ndonjë ndryshim. Meraku i vetëm që ne kemi dhe e kemi theksuar edhe më parë është për t'u dhënë fund praktikave që gratë detyrohen të lënë vendin për të kaluar një burrë në listë dhe atë që shpesh në fushata gratë janë më pak të favorizuara sesa burrat, qoftë me mbulimin mediatik apo edhe në vështirësitë që hasen në fushatë.

Për sa i përket administratës zgjedhore, me të drejtë e tha edhe kolegja Gjebrea, nuk ka asnjë të keqe... Uroj që të kemi një administratë zgjedhore të depolitizuar, por nëse kjo nuk do të arrihet, patjetër që do të kishte nevojë që të kishte një barazi.

Faleminderit!

**Damian Gjikhuri** – Nisur nga ajo që tha zonja Hysi, unë kam një pyetje. Nuk e di nëse jeni njohur me propozimet aktuale, që kanë bërë ekspertët lidhur me adresimin e barazisë gjinore, ku përveç aspektit kuantitativ, që ju mendoni se duhet të jetë 50 me 50, e cila është çështje diskrecioni politik, nisur nga ajo që tha zonja Hysi dhe ajo që keni parë në tekst, a adresohet frika që ekziston, që nëse një kandidate grua do të tërhiqet nga lista apo ka presion për t'u tërhequr nga lista, dispozitat që propozohen e korrigjojnë këtë problem? Pra, përveç kuotave, e cila mund të jetë edhe 2 gra e 1 burrë, sepse është çështje zgjidhjesh, por problemi është a adresohet ky shqetësim që ngriti zonja Hysi?

**Mimi Kodheli** – T'ju them të drejtën, zoti Gjikhuri, në këtë fenomen e kemi parë dhe kemi hasur në të dyja variantet, pra ka pasur gra, të cilat janë tërhequr për shkak të ardhjes së një burri mbrapa listës dhe ka pasur burrë, që është tërhequr për shkak të ardhjes së një burri tjetër në listë. Kështu që ky nuk është një fenomen tipik, që ka të bëjë vetëm me gratë...

**Damian Gjikhuri**- Më fal!

Ligji është neutral dhe nuk flet për gra e burra, por flet për gjini. Nga propozimet që kanë ardhur nga ekspertët, të cilat i keni në tavolinë, që normalisht ju duhet të jepni një opinion me shkrim, ju lutem, jepni dhe një opinion për këtë. Pra, keni dy çështje, kuotat dhe mekanizmi i garancisë. A është i garantuar mekanizmi i garancisë me propozimet, apo jo?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju thatë që do të sillni një opinion me shkrim, ku e para është propozimi juaj origjinal për barazi të plotë gjinore dhe e dyta është mekanizmi i garancisë, që gjinia më pak e përfaqësuar, ose të paktën në këtë rast, që do të jetë e barabartë, ku ligji do të mbyllë, shtigjet për tërheqjen e pavullnetshme të këtyre personave nëse ekzistojnë. Pra dua një opinion lidhur me këtë.

**Klotilda Bushka** - Në fakt, pyetja e zotit Gjikhuri është e drejtë, por unë kam një pyetje që lidhet me pyetjen e zotit Gjikhuri. Nëse do të ishin listat e hapura, ju si do ta ndienit veten në garën elektorale?

**Mimi Kodheli**- Përgjigjen nuk do ta jap nisur nga pozitat personale, sepse mund të jem e favorizuar në këtë gjë, por unë mendoj se mund të jetë dhe me lista të hapura. Sigurisht që këtu ka ekspertë, por po e them nga eksperiencia këtë, ka disa ligje elektorale, sidomos në një vend, për shembull, si Pakistani, që nëse në ligj është e përcaktuar që ka 30 % kuota rozë, ligji atje ndryshon sipas shteteve brenda Pakistanit, dhe kuotat rozë po supozojmë që janë 30%, pavarësisht sistemit që mund të ndryshojë, 30 përqindëshi është aty dhe, në qoftë se forca politike nuk e plotëson karrigia rri bosh derisa ta plotësohet. Unë jam komode me listat e hapura, por problemi është që brenda listave të hapura, pavarësisht se të vjen dikush dhe thotë që unë kam marrë më shumë vota sesa kjo zonja, mund të ketë një kombinim. Kjo mund të duket e pamundur nga pikëpamja legislative, unë nuk jam eksperte, por ka eksperiencia të tilla, ku mund të ketë një kombinim të listës së hapur me përqindjen e kuotave rozë, që duhet të ketë në parlament. Karrigia rri bosh derisa ajo të plotësohet, thjesht ti nuk ke përfaqësim, nuk ke votën. Kjo është përgjigja ime në këtë rast për ju.

**Elona Gjobrea** - Në fakt, pa dashur të përsëris, çështja e ndryshimit në propozimet që kanë ardhur sa u takon të drejtave për barazinë gjinore, konsiston te fakti që në qoftë se dje

thoshim që një në tre emra do të jetë i secilës gjini, sot ne themi që përbërja e Kuvendit do të jetë me patjetër 30% e secilës gjini. Kam përshtypjen kjo është për t'u vlerësuar si një përmirësim....

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, në Kod, në kuadrin e teknikës legjislative, thuhet: “e secilës gjini”. Ne njohim vetëm gjininë femërore dhe gjininë mashkullore në legjislacionin tonë, s`kemi bërë ndryshime.

Për ta mbaruar logjikën. Kjo është një arritje sa i takon faktit të garantimit cilësor të barazisë gjinorë në lista, që iu duhet dhënë si meritë grave deputete, përveç faktit të vullnetit politik të të gjithë atyre që kanë arritur në këtë konkluzion, edhe të ekspertëve, por në fakt një punë e tillë e kryer nga gratë deputete, me kontributin e tyre të përditshëm, jo vetëm nëpër komisione, ka sjellë këtë arritje. Fakti i refuzimit të listës bëhet në qoftë se nuk është ky lloj përfaqësimi.

Së pari, është mirë të fokusohemi këtu, sepse është moment historik, kjo do të jetë hera e parë në Shqipëri, nëse do të biem të gjithë dakord, që ky element do të njihet i detyrueshëm dhe i garantuar me ligj.

Së dyti, sa i takon faktit të tërheqjes së grave nga presionet kur kemi burra, të cilët përdorin metoda të ndryshme, që në të kaluarën janë demaskuar në shumë raste...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po mirë nga të dyja gjinitë, po vazhdojmë me të njëjtën logjikë. Ideja është që sipas propozimit të parë, unë për këtë doja të flisja, sepse kam përshtypjen që nuk u është vënë ende në dijeni zonjave deputete ky lloj propozimi, që në qoftë se një vend ngelet vakant, i cili duhet zëvendësuar dhe duhet të jetë se s`bën një grua, dhe në qoftë se mbarojnë gratë e asaj liste, pra në qoftë se bëhet fjalë për një vakancë që është krijuar nga një grua, i kalon subjektit tjetër politik. Pra ikën nga forca politike dhe shkon te forca tjetër politike, ku sigurisht nuk ka më njeri që mund të kërcënojë një grua tek ai subjekt politik, sepse se do të iki mandati partisë. Pra kjo është një formë. Nëse unë bashkë me ju....

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Fino, dhe dy minuta dhe do të iki.

Faleminderit.

**Damian Gjikhuri-** Për të kursyer kohë!

**Bashkim Fino-** Kolegia ime, që është anëtare e komisionit së reformës zgjedhore po trajton si është bërë nga ekspertët, dhe ne kemi bërë një dëgjese, vetëm kaq. Ndërkohë keni

ardhur dhe ju, të nderuara deputete, të çdo force politike, dhe po na thoni që keni dhe ju një draft. Ju lutem, na e sillni, sepse ne nuk e kemi diskutuar si komision. Domethënë, të mos harxhojmë kohën kot, duke trajtuar kolegja ime, atë që është shkruar në draft, sepse ju atë e keni lexuar, e keni parë, por fjala është për të bërë ndonjë pyetje dhe për t'u qartësuar ne si komision. Në kuadrin e pyetjes, dua të them që këtë radhë është bërë një ndryshim esencial në kod për gjininë. Unë po flas për gjininë, sepse gjinia nuk është vetëm femër, por ta marrim në konsideratë gjinia ka dhe gjini të tjera që mund të jenë të diskriminuara. Absolutisht që mund të jenë të diskriminuara. Ne sot kemi një Kryeministër që e ka qeverinë 50 me 50, atëherë, unë s'kam pse them që jam i diskriminuar dhe ti nuk ke pse thua që je i diskriminuar, jo ti personalisht. Pyetjet që do të trajtojmë dhe do t'i diskutojmë edhe me ne, kanë të bëjnë edhe me sistemin, që edhe nëse gjykohet këtu për t'u ndryshuar, i bie që në njëfarë mënyre të shikohet çështja e barazisë gjinore, sepse është shumë e rëndësishme. Unë kam qenë deputet, si zoti Murrizi, me maxhoritar të pastër. Është më e ndershme të bëjmë maxhoritar të pastër, sepse të gjithë këtu, proporcional, në rang Shqipërie, me lista të hapura e të tjerë, por këta harrojnë një gjë që është më esenciale. Cila është më esenciale?! Më esenciale është që ne jemi të lidhur me zgjedhësit dhe një deputet duhet të jetë i lidhur me zgjedhësit. Ju keni qenë në shumë vende të botës dhe e keni parë që deputeti shkon me javë të tëra pranë zgjedhësve për t'u zgjidhur problemet dhe për t'i dëgjuar hallet e tyre dhe një deputet që nuk është i lidhur me zgjedhësit, por është në ajër, me lista të hapura nga Konispoli në Vermosh dhe nuk është i lidhur me asnjë zonë elektorale, për mua është *out* dhe do të marrë prapë fuqi vendimmarrëse lidershipi.

Unë dua të bëj një propozim, sepse jam në vendin e punës dhe dua të propozoj me shumë dashamirësi për këtë maxhoritar të pastër, deputeti duhet të shkojë pranë qytetarëve që do ta zgjedhin, atë që bëjmë sot me kryetarët e bashkive. Çfarë bëjmë sot me kryetarët e bashkive?! Ne kemi kuota gjinore vetëm në këshilla bashkiakë dhe kemi bërë shumë mirë, e ka bërë PS-ja, por nuk kemi kuota gjinore për kryetarë e bashkive në 61 bashki, sepse sot mund të konkurrojmë kushdo nga gjinitë për kryetarë bashkish dhe do të fitojë ai që merr një vote më tepër dhe do të zgjidhet kryetar i bashkisë. Kështu do të jetë edhe nesër për një deputet me sistem maxhoritar të pastër. Atëherë, si do të garantohet barazia gjinore, apo do të bëjmë artificia dhe do të themi: "Po bëjmë 100 vende maxhoritar të pastër dhe po i lëmë 20-30 vende për gjininë tjetër që është e diskriminuar". Pra, ideja është kjo dhe nuk dua të hapem te kjo çështje, pasi është një çështje që do ta diskutojmë: ne kemi një draft shumë të mirë të bërë nga ekspertët. Ju e keni parë. Erdhët këtu dhe i raportuat idetë tuaja.

Nëse keni sugjerime, mendime sillini te bashkëkryetarët që kur ta diskutojmë çështjen e barazisë gjinore t'i kemi parasysh.

**Damian Gjikhuri** - Të mos e bëjmë këtë debat këtu, pasi duam të kursejmë kohën.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Më falni!

Jo, nuk ka më nevojë për argumente. Unë ju respektoj.

E para, thamë që do të sillni mendimet tuaja.

E dyta, ju i keni përfaqësueset këtu në lidhje me argumentet që u thanë. Ato janë shumë të interesuara dhe me ndërhyrjen e tyre u vendos që të jetë edhe kjo seancë. Ne kemi shkruar diçka, kemi adresuar dy elemente: barazinë gjinore dhe garancitë që kjo barazi të ruhet edhe në rastet e vakancave. Duhet një opinion me shkrim në lidhje me këtë gjë. Për çdo gjë tjetër keni përfaqësueset tuaja që vijnë nga e njëjta gjini. Jam i bindur se do t'i mbrojmë dhe do t'i argumentojmë. Mendoj se seanca e arriti qëllimin, mesazhi u dha. Ne jemi të hapur që t'i diskutojmë ato.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ky është komision pune. Zonja Gjebrea unë nuk kam asgjë, por problemi është se i tha zonja Kodheli, edhe ju i thatë, pra doli qartë. Keni mendim tjetër?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Elona Gjebrea** - Në përgjigje të zotit Fino kam një propozim timin personal, pa dyshim që do ta diskutojmë me Aleancën e Grave, por fakti që vendi bosh i gruas i kalon një partie tjetër, nuk më duket shumë me vlerë, më mirë t'i kalojë një qarku tjetër dhe të ketë edhe një lidhje me zgjedhësit e Partisë Socialiste sesa të shkojë te një parti që nuk ka lidhje. Kjo është diçka që do ta diskutojmë, por meqenëse u tha kjo gjë, unë përfitova nga rasti. Ne kemi 3-4 sugjerime, që do t'i diskutojmë dhe do të biem dakord.

**Rudina Hajdari** – Po, zonja Kodheli.

**Damian Gjikhuri** - Është ndërhyrja e fundit.

**Mimi Kodheli**- Ju kërkoj shumë ndjesë. Nuk jam dakord me zonjën Gjebrea. Ajo është një mënyrë shumë elegante për ta vënë nën presion subjektin politik për të mos hequr gratë dhe për të vendosur burrat. Jam dakord me këtë gjë, është komode. Kam garuar në maxhoritar, ashtu sikurse kam qenë pjesë e proporcionalit. Dikur kam bërë një debat me një zonë të nderuar, që është zonja Topalli, i kam thënë: “Ditën që do të shkosh të garosh në Vlorë dhe jo në Shkodër, e bëjmë maxhoritar kur të duash”.

Faleminderit!



**Damian Gjikhuri** - Po, zoti Alimadhi.

**Adriatik Alimadhi** – Sa herë bëjmë diskutime dhe propozime për ndryshime, gjithmonë na dalin ide dhe mendime të tjera. Si e shikoni ju si zonja, gra momentin kur ne e trajtojmë këtë çështje dhe themi: të parët do të vendosen burrat dhe pastaj gratë. A a nuk ndiheni pak të diskriminuara?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë bëra një pyetje. A e shikoni se po vendoset një listë, në rastin konkret? Këtu po përcaktohet, do të vazhdohet me burrat dhe pastaj me gratë. Nga momenti që ne kemi të përcaktuar 30% për shembull, të detyrueshme që do të vendosen gra, ne dashur pa dashur i diskriminojmë femrat dhe u themi: ju keni 30%, kur ju kërkoni një të drejtë të barabartë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Damian Gjikhuri** - Unë them se ideja e zotërisë doli, më vjen mirë që dha një propozim konkret.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zonjat nuk kishin koment.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

A do të vazhdojmë?

**Myslim Murrizi** - Zoti Fino, kam një pyetje rreth asaj që thatë ju. Po diskutojmë për dy gjini, si do ta zgjidhim për gjininë tjetër? Një burrë, një grua dhe një LGBT?

**Damian Gjikhuri** – A ka një përgjigje Aleanca në lidhje me këtë gjë?

**Mimi Kodheli** - Zoti Murrizi do të mundohen që të jem në lartësinë e sarkazmës suaj.

**Rudina Hajdari** - Mos harroni se të gjitha këto regjistrohen në procesverbal.

**Mimi Kodheli** – Kanë pas thënë dikur: një grua, një burrë, një oficer ose polic. Nuk janë vetëm dylberët të gjinisë tjetër.

**Damian Gjikhuri** – Faleminderit për kontributin!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zonja Kodheli ju falënderoj!

Besoj se çështjet u ezauruan. Presim propozimet tuaja për dy gjëra. Së pari për barazinë gjinore në aspektin e kuotës. Së dyti, për elementët e garancive procedurale në rastin e krijimit të vakancave dhe pastaj do të adresohen nga ky komision.

**Klotilda Bushka** - Ju tërheq vëmendjen! Kërkoj që të respektojmë Rregulloren dhe Kodin Etik të Kuvendit, sepse po flasim për çështje të barazisë gjinore, por nga fryma e

diskutimeve shikoj një lloj mosrespekti dhe gjuhë joetike, jo vetëm për këto çështje, por edhe për çështje të tjera që u diskutuan më lart për sa i përket përzgjedhjes dhe çështjeve të tjera natyrore apo jonatyrore.

Ju lutem kolegë, me të drejtë zonja nënkryetare e Aleancës u largua, sepse nuk mund të jetë pjesë e një diskutimi kur një çështje kaq serioze ne e kthejmë në shaka apo flasim në një gjuhë joetike. Nuk do të donim ta bënim edhe në 3 gratë anëtare të komisionit, sepse mund të kishim ikur edhe ne.

Ju lutem ju tërheq vëmendjen, përndryshe ne do t'ia referojmë këtë çështje komisionit përkatës për çështjet e etikës në Kuvend.

**Rudina Hajdari** - Faleminderit, zonja Bushka!

Besoj se ishte një kritikë me vend dhe nuk duhet ta zgjasim më këtë diskutim. E kemi tepruar me mënyrën se si komunikojmë me njëri-tjetrin.

Kam një pyetje për Aleancën e Grave, kam parë opinionet dhe analizat e shoqërisë civile. Në këtë pikë kam bërë disa kritika. Dua të di opinionin tuaj. Lidhur me regjistrimin e kandidatëve, barazia gjinore, propozim i nenit 23, nga disa përfaqësues të shoqërisë civile thuhet se është i tepruar, që po bëhet në këtë lloj mënyre. E kemi kaq të nevojshme këtë gjë, momentin që kandidati e lë pozicionin, të zëvendësohet me një grua deputete? A është kaq e nevojshme? A mos ne po cenojmë të drejtat e dikujt tjetër, nëse e ndërmarrim këtë si hap? Duhet t'i mendojmë të dyja, jo thjesht për veten tonë. Që të jemi sa më të drejtë edhe me shoqërinë civile në këtë pikë, të japim edhe një sqarim nëse do të vazhdojmë me këtë pikë, pra do ta lëmë kështu siç është, të shikojmë njëra-tjetrën në sy dhe të themi: a është vërtet gjëja e duhur, që vendi vakant të zëvendësohet me një grua? A jemi duke u hequr mundësinë zgjedhësve që të kenë atë që duan? Ndoshta janë disa zgjedhës që duan një përfaqësues burrë në disa zona. A jemi duke ua hequr atë të drejtë? Unë po luaj rolin e avokatit të djallit.

**Vasilika Hysi** - Faleminderit, zonja Hajdari!

Ndoshta koleget tona nuk janë njohur me propozimet që kanë ardhur nga shoqëria civile. Unë do të sugjeroja që sekretariati i Komisionit për Reformën Zgjedhore të vërë në dispozicion të gjitha opinionet, mendimet dhe sugjerimet që kanë ardhur nga aktorët e shoqërisë civile. Në një mbledhje që do të organizojë Aleanca e Grave Deputete t'i analizojmë të gjitha bashkë. Pastaj t'ua vëmë në dispozicion me shkrim komisionit, sidomos kolegëve burra.

**Rudina Hajdari** - Po, zoti Lita.

**Korab Lita** - Në radhë të parë e çmoj shumë kontributin e Aleancës së Grave, por besoj se ka një moskombinim të pjesa e kohës...

Problemi është i tillë që çdo sistem zgjedhor ka specifikat e tij. Mendoj se është e parakohshme kjo dëgjese, sepse në projekt kemi sistemin zgjedhor, a do të ndërhyjmë apo jo? Nëse do të ndërhyjmë në sistemin zgjedhor, ai do të ndryshohet. Me sa shikoj diskutimi po bëhet për sistemin aktual. Nesër mund ta ndryshojmë atë dhe duhet të bëjmë një dëgjese tjetër, sepse çdo sistem ka specifikat e tij. Mendoj se duhet ta zgjidhim njëherë problemin e sistemit, a do të qëndrojmë te ky apo do ta ndryshojë? Pastaj të vijmë dhe të flasim për gjëra konkrete, pasi e gjithë puna që po bëjmë mund të na shkojë dëm.

**Rudina Hajdari** - Mendoj se ndërhyrja e zotit Lita është e drejtë, por nga ana tjetër do të mendojmë edhe këtë gjë, nëse ju vini me një propozim konkret dhe rritet përqindja nga 30% në 50% kjo nuk do të ndryshonte shumë sistemin, nëse hapen listat. Pra, do të ishte e mirë ajo që tha zonja Hysi që duhet të lexoni edhe propozimet e shoqërisë civile, sepse edhe ne duam që ekspertët t'i shikojnë propozimet tuaja, por dhe të marrin në konsideratë ato që ka shprehur shoqëria civile për draftin që është pranë nesh. Të gjitha këto do të shikohen në bazë të sistemit. Por nëse do të vijë një propozim konkret për çështjen e barazisë gjinore sidomos nëse do të kërkonte që të ngrihet përqindja në 50, atëherë besoj kjo nuk do të kishte ndonjë efekt apo ndikim të drejtpërdrejtë.

**Mimi Kodheli** - Ju kërkon ndjesë për harxhimin e kohës, pasi koha është e çmuar, por përtej sistemit proporcional rajonal, me lista të hapura kombëtare, të kombinuara, duke përjashtuar nga diskutimi sistemin maxhoritar, sepse për atë e bëra komentim, mendoj që propozimi që do të vijë do të jetë një propozim i një liste 50%. Pastaj sesi kombinohen sistemet, ky është diskrecion politik dhe se çfarë do të dalë si produkt final nga ky komision i nderuar.

Biem dakord që pasi ne të marrim nga sekretariati gjithçka që është ngritur deri më sot, të gjitha propozimet që kanë ardhur nga aktorë dhe faktorë të mundësojmë një takim tjetër ku të paraqesim kërkesat tona me shkrim.

E dyta, e ripërsëris pasi nuk jam kuptuar drejtë kur flasim për lënie të mandatit të të qenit grua apo të të qenit burrë, sepse i kemi pasur të dyja rastet, flasim për të njëjtin proces dhe për të njëjtin detyrim ligjor më pas. Personalisht bie dakord me propozimin e ekspertëve, është një mënyrë shumë elegante për t'i vënë nën presion partitë politike sesa të paguajnë gjoba e të tjera, për t'i vënë nën presion për të mos e lënë pozicionin e anëtarit të Kuvendit.

Me gjithë ndjesën që shkaktuam për shkak të një trupe të huaj që hyn këtu dhe diskuton çështje të një rëndësie të veçantë siç është pikërisht kjo, mbetemi me shpresën se do ta marrim këtë informacion dhe ne do të jemi prezentë me propozimet tona.

**Nimet Musaj** – I falënderoj zonjat që sapo ikën për mesazhet që dhanë!

Meqenëse me zonjën Hysi jam në grupin e punës për barazinë gjinore, absolutisht që propozimet e tyre duhet të na vijnë me shkrim, por mundësisht sa më shpejt që të kemi kohë në dispozicion për t'i diskutuar ato, që cilido të jetë sistemi, të mbeten vetëm çështjet teknike për ta axhustuar dhe për t'u futur në funksion.

**Ralf Gjoni** - Do të doja shumë që kolegët tanë socialistë të ishin po kaq të zellshëm për Kodin e Etikës kur na dhunohet e drejta e fjalës në seancat plenare.

Ju lutem, zonja Bushka mos na e kujtoni Kodin e Etikës!

Ka një argument ligjor sot në disa vende të BE-së përtej asaj që juve ju duket diskutim jashtë etikës, që ka të bëjë me *non binary gender*, siç thuhet në anglisht, ku janë në diskutime sociale sesi do të regjistrohen personat që nuk e ndiejnë veten as mashkull, as femër, as burrë dhe as grua. Ky është një problem që unë parashikoj që do të jetë në rritje në diskutimet sociale në vendet anëtare të BE-së. Eventualishjen e thelbit. Për çështjen e thelbit jam plotësisht dakord me zotin Gjoni, por e kisha për mënyrën sesi e trajtuan, për gjuhën joetike, që të jemi të qartë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Damian Gjikhuri** – Zoti Murrizi, ta lëmë këtë debat!

Faleminderit për dëgjuesën dhe për pjesëmarrjen aktive!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zonja Bushka lëreni këtë debat se nuk ia vlen!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Rudina Hajdari** - Ky është një konflikt i kotë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk është mirë që të ikë edhe një zonjë.

**Damian Gjikhuri** - Zoti Murrizi, u mbyll kjo bisedë tani.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Rudina Hajdari** - 5 minuta pushim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

*(Pas pushimit)*



*Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 7.11.2019, Ora 10.00

**Drejtojnë mbledhjen:**

**Damian Gjijnuri dhe Rudina Hajdari – bashkëkryetarë të Komisionit të  
Posaçëm të Reformës Zgjedhore**

**Rendi i ditës:**

Diskutimi i draftit të përpunuar nga ekspertët e Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore

**Marrin pjesë:**

Damian Gjijnuri, Rudina Hajdari, Vasilika Hysi, Klotilda Bushka, Blerina Gjylameti, Alket Hyseni, Bashkim Fino, Arben Elezi, Myslim Murrizi, Nimet Musaj, Korab Lita, Adriatik Alimadhi dhe Adnor Shameti.

**Mungojnë:**

**Damian Gjikhuri** – Kalojmë te çështja tjetër e ditës, ju lutem!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Le të vazhdojmë, s'ka problem.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Atëherë, kalojmë në temën tjetër. Le të vazhdojnë ekspertët, të fillojnë prezantimin, siç e kishim lënë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po mirë, nuk ka problem. Vazhdojmë me temën tjetër. Tani është radha e prezantimit, kështu që ekspertët le të fillojnë prezantimin.

Zoti Gumi apo zoti Rusmajli, le të fillojnë prezantimin e draftit që kishim lënë, në lidhje me propozimet tuaja për adresimin e çështjeve të administrimit zgjedhor, pra komisionet në mënyrë vertikale.

Faleminderit!

Fjala është për ju. Në mënyrë të përmbledhur, sepse propozimet janë në tavolinë. Pak a shumë në lidhje me mekanizmin, në mënyrë të përmbledhur.

**Illir Rusmajli** – Faleminderit, zoti bashkëkryetar!

Detyra që kanë pasur për të zgjidhur ekspertët, ka qenë zbatimi i rekomandimit të hershëm të ODIHR-it, detyra bazë që lidhet me depolitizimin administratës zgjedhore. Depolitizim do të thotë reformim rrënjësor i mekanizmit, në lidhje me si ngrihet dhe si funksionon administrata zgjedhore. Është një sistem krejt i ndryshëm nga ai që është sot në fuqi. Detyra nuk ka qenë e lehtë. Ka qenë e vështirë, sepse duhen gjetur ekuilibrat aty ku nuk ia merr mendja njeriut. Këto ekuilibra duhen bërë, që të funksionojë në mënyrë të tillë, që procesi të mos vuajë nga mekanizmi administrativ.

Sot, në një pjesë të madhe të tij, procesi vuan për shkak të mekanizmit administrativ. Minimalisht, mekanizmi administrativ sjell vonesa të patolerueshme në numërimin e votave. Sot mekanizmi administrativ sjell vende-vende bllokimin e proceseve elektorale të rëndësishme, jetike për demokracinë, siç është bllokimi i procesit të votimit në qendra të caktuara. Kjo vjen për shkak se mekanizmi dominohet nga përfaqësimi politik dhe nga interesi politik përmbi interesin ligjor.

Për të shkuar te një koncept i ri, ne na është dashur të kthehemi në origjinën e mekanizmit të balancuar, për të kuptuar se përse ishte i domosdoshëm ai që është sot në fuqi, dhe përse na duhej. Në origjinë ka qenë një arsyetim: që administrimi i zgjedhjeve të jetë i besueshëm për partitë politike. Partitë politike duhet të jenë pjesë e procesit. Duke qenë pjesë

e procesit, ato e kontrollojnë procesin, në kuptimin e mbikëqyrjes, dhe duke qenë në mënyrë të balancuar, neutralizojnë njëra-tjetrën.

Ai mekanizëm është i pranuar nga Komisioni i Venecias dhe funksionon në një numër të caktuar vendesh të demokracive të reja. Në momente të caktuara mund të ketë funksionuar edhe në zgjedhjet shqiptare, mund të funksionuar edhe mirë, por që prej disa zgjedhesh, eventualisht që nga 2009-a e në vijim, nga vetë partitë politike ka një mosbesim të hapur ndaj mekanizmit politik. Jo vetëm nga partitë e vogla, të cilat nuk janë të përfaqësuara në administratën zgjedhore, por edhe nga partitë e mëdha. Partitë e mëdha janë shprehur haptas defidentë ndaj administratorëve zgjedhorë të caktuar prej tyre vetë në zgjedhje. Kjo do të thotë se mekanizmi e ka ezauruar kontributin e vet në zgjedhjet shqiptare, ndaj duhet ndërruar me urgjencë, për shkak se realiteti nuk e pranon më.

Më pas, kërkesa e dytë është për shkak se rekomandimet e OSBE/ODIHR-it e kërkojnë me forcë prej të paktën tri palë zgjedhesh, që ky mekanizëm duhet të ndryshohet.

Ajo që ka qenë e nevojshme të shqyrtohej me vëmendje nga ana jonë, është ndryshimi, depolitizimi, pa cenuar besimin e partive politike te procesi. Si mund ta realizojmë këtë? T'i largojmë partitë nga administrimi, por njëkohësisht t'ua ruajmë besimin ndaj procesit të administrimit të zgjedhjeve.

Këtë zgjidhje ju nuk e keni ende këtu. Ju keni depolitizimin, por nuk keni besimin brenda, sepse ruajtja e besimit të partive politike te procesi, do të vijë kur ne t'ju sjellim juve kapitullin e procedurave, që unë besoj se vjen menjëherë pas këtij. Ne ju kemi tërhequr vëmendjen, sepse aq mund të bënim deri në këtë pikë, në lidhje me disa komponentë që e mbajnë gjallë besimin. Komponent që e mban gjallë besimin është transparenca e procesit, mundësia për të bërë kontrole dhe verifikime jo vetëm mbi sistemet, por edhe mbi rezultatin.

Këto janë gjëra, të cilat duhen trajtuar me kujdes në pjesën e procedurave. Janë gjëra që kanë një potencial shumë të lartë për ta mbajtur gjallë besimin e partive politike, të të gjithave, jo vetëm të atyre që largohen nga administrimi, ndaj procesit të administrimit. Nga ana tjetër, ka një avantazh shumë të madh. Duke vënë në ligj instrumente kontrolli të procesit, të rezultateve e me radhë, vetë instrumentet e kontrollit janë një deterrent shumë i fuqishëm ndaj të gjitha tentativave për manipulim. Në qoftë se më pas do të kontrollohen procedurat, në qoftë se më pas do të kontrollohen dokumentet, në qoftë se më pas lakrat do të dalin në shesh, atëherë ai që ka qëllimin e keq, ai që kërkon të manipulojë, ai do të frenohet, sepse e di së më pas do t'i dalin hilet.

Këtë pata nevojë ta theksoja, sepse nuk mund të ketë gjykim mbi administrimin, pa pasur në mendje këto elementë që do të vijnë më pas. Por elementët duhet t'i dini paraprakisht. Do të ketë mekanizma transparence, mekanizma kontrolli, të cilat mbajnë gjallë besimin e të gjitha palëve ndaj procesit të administrimit.

Ndryshimi, reformimi rrënjësor i administratës zgjedhore nuk i jep përgjigje vetëm rekomandimit për depolitizimin, i cili është rekomandim kyç i disa raporteve, por u jep përgjigje të gjitha rekomandimeve që kanë lidhje me sistemin aktual të administrimit. Janë disa rekomandime të tjera, të cilat janë anësore, që gjithmonë janë lënë mënjanë, sepse nuk i është dhënë kurrë përgjigje rekomandimit kryesor për depolitizimin. Për shembull, ka një rekomandim që është anësor: rekomandimi që t'u hiqet partive e drejta për të shkarkuar anëtarët e komisionit. Është dhënë disa herë ky rekomandim. Ky rekomandim zgjidhet automatikisht, për shkak se vihet në lëvizje një sistem, një mekanizëm i ri i administrimit.

Për shkak të këtij mekanizmi të ri të administrimit, i është dhënë përgjigje automatikisht, për shembull, rekomandimit të përsëritur në lidhje me trajnimin serioz të administratorëve zgjedhorë. Është konstatuar në disa palë zgjedhje mungesa e trajnimit, për shkak të mënyrës se si formoheshin trupat e administrimit, por edhe shkak të lëvizshmërisë së madhe të tyre. OSBE/ODIHR-i ka thënë në mënyrë të përsëritur, se njerëzit që administrojnë zgjedhjet duhet të jenë kompetentë dhe profesionalë në administrimin tyre.

Cilat kanë qenë arsyet që na kanë shtyrë neve, që të zgjedhim këtë lloj konfigurimi të administratës? Sigurisht, e para është depolitizimi, dhe për këtë fola, por ky lloj konfigurimi ka dy komponentë të tjerë, të cilët janë shumë të rëndësishëm për mënyrën se si do të funksionojë.

Komponenti i parë është profesionalizimi i administratës zgjedhore. Profesionalizimi ka disa elementë të rëndësishëm, që janë thënë aty. E para, administrata zgjedhore që projektohet me këtë zgjidhje, do të jetë një administratë zgjedhore profesionalisht kompetente. Ju jeni më ekspertë se ne në fushën e vlerësimit të administratës, sepse ju e keni vlerësuar nga praktika. Shqipëria, me kalimin e viteve, ka shkuar gradualisht drejt degjenerimit të timit intelektual të administratës zgjedhore. Për shkak se nevojat e partive politike kanë qenë të tilla, gjithmonë ka shkuar i fundit që ka ngelur pa u punësuar, i fundit që ka ngelur hallexhi. Këta i kanë marrë dhe i kanë bërë komisionerë.

Ky lloj arsytimi duhet të ndryshojë. Ky vend duhet të nxjerrë si komisionerë më të mirët e vet, nga pikëpamja e timit intelektual, edukatës, arsimimit, eksperiencës në punë, si dhe zotësive personale. Duhet të vinë më të mirët, ata që janë më të zotët.



*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dakord, do ta jap këtë përgjigje.

**Damian Gjikhuri** – Për të mbajtur rregullin e punës, Myslim, do të mbarojë njëherë prezantimi. Më pas fillojnë pyetjet. Do të rrimë sa të doni ju, derisa t'i ezaurojmë. Bëjmë edhe seancë tjetër. Pra, të mbarojë prezantimi. Vazhdoni!

**Ilir Rusmajli** – Pra, në Shqipëri duhet të instalohet një filozofi e re administrimi. Administrimi i zgjedhjeve është një detyrë qytetare shumë e respektuar, është angazhim shumë i respektuar qytetar. Sigurisht, ky angazhim duhet të jetë parimisht i të gjithëve, por në radhë të parë duhet të jetë i atyre që janë më të mirët e më të zotët nga pikëpamja profesionale. Nuk duhet të jetë ekskluzivitet i ndonjë funksioni, detyre apo profesioni të caktuar.

Këtë dua ta evidentoj, sepse besoj se është parimisht e rëndësishme. Në gjithë këtë periudhë, që ka pasur me debate në raport me administratën zgjedhore, ka pasur gjithnjë propozime për profesione të caktuara. Për shembull: këtë punë duhet ta bëjnë arsimtarët.

Ne nuk kemi ndjekur këtë logjikë, logjikën e profesionit ekskluziv, sepse në fakt, kjo është detyrë qytetare, nuk është detyrë profesionale, nuk është vetëm e arsimtarëve, nuk është vetëm e mjekëve, nuk është vetëm e një kategorie tjetër të caktuar. Kjo është detyrë e njerëzve, të cilët kanë vetëdijen qytetare për të ndjekur me rigorozitet ligjor proceset e administrimit të zgjedhjeve, proces që është themelor për demokracinë.

Nga ky këndvështrim, dua të evidentoj, sepse mund të ketë keqkuptime, se propozimi ynë nuk e çon këtë detyrë te nëpunësit civilë, pavarësisht se nëpunësit civilë përmenden aty në mënyrë të përsëritur. Nuk mund të konsiderohet detyrë ekskluzive e nëpunësve civilë. Nëpunësit civilë evidentohen në këtë propozim për dy arsye, të cilat janë konkrete. E para, ata janë kontingjenti më i lidhur me shtetin si të tillë. E dyta, duhet të shndërrohen në kontingjentin më të interesuar për administrim të drejtë dhe të rregullt të zgjedhjeve. Janë garancia që mekanizmi funksionon. Por nëpunësit civilë nuk duhen trajtuar dhe nuk duhen konsideruar si ata që do të na bëjnë zgjedhjet. Zgjedhjet duhet të jenë proces mekanizmi. Administrimi duhet të jetë proces i hapur për të gjithë. Kriteret duhet të jenë ato që janë, që kanë lidhje me tisin intelektual. Pra, duhet të jenë njerëz të arsimuar, njerëz që dëshmojnë një nivel të tillë, të mjaftueshëm dhe të domosdoshëm përgatitjeje. Duhet të jetë i hapur për të gjithë qytetarët që kanë vullnetin për ta administruar procesin me korrektesë ligjore.

Elementi tjetër, i fundit i këtij mekanizmi, është përgjegjshmëria. Nuk mund të ketë sistem që funksionon, në qoftë se nuk ka kërkesë llogarie dhe mbajtje përgjegjësie në lidhje

me mënyrën si funksionon. me sistemin aktual, Shqipëria e ka vuajtur shumë këtë gjë. Nuk ka nevojë të futem në retorika politike për këtë gjë, sepse të gjithë janë koshientë për faktin se në Shqipëri ka pasur keqadministrim zgjedhjesh në periudha të vazhdueshme, por megjithatë nuk ka pasur llogaridhënie për keqadministrimin e zgjedhjeve, për fat të keq as në rastin kur janë denoncuar penalisht komisionerë të caktuar, për fat të keq as në rastin kur ka pasur hetime dhe çështje gjyqësore për ta. Edhe në atë rast, shoqëria nuk ka ndjerë dhënie llogari. Edhe në atë rast, shoqëria ka konsideruar se komisionerët që po merren në përgjegjësi penale, në një mënyrë apo një tjetër do t'i shpëtojnë drejtësisë. Kjo nuk e ka ndihmuar sistemin që të funksionojë. Ne besojmë se me këtë lloj mekanizmi e bëjmë sistemin të funksionojë.

Në vlerësimin tonë, ne s'kemi dashur të heqim asnjë gjë nga përgjegjësitë penale të komisionerëve, ngaqë mendojmë se është një rrugë që duhet të rrijë në ligj, por në vlerësimin tonë ka një potencial më të madh lidhja e ligjshmërisë në veprimtarinë e tyre, me interesin e tyre privat, llogaridhënia e lidhur ngushtë me interesin e tyre privat.

Në qoftë se ne ndjekim partinë në lidhje me mënyrën se si përzgjidhen dhe avancohen komisionerët politikë, raporti midis partisë dhe komisionerëve të saj, është një raport interesi reciprok. Partia ka nevojë për militantë, që t'i shërbejnë në këtë front, ndërsa militantët që angazhohen të shërbejnë në këtë front kanë interes për t'u emëruar, eventualisht për të mbajtur dhe për të bërë një karrierë në administratën publike.

Ky është raporti që i lidh ata. Këtë raport, ne e zgjidhim duke nxitur interesin privat të komisionerëve, rekrutimin apo karrierën e tyre në administratën publike, me nevojën dhe detyrimin që ata t'u shërbejnë ligjit, jo interesit partiak. Në qoftë se komisionerët nuk i shërbejnë ligjit, ata nuk mund të shkelin më në administratën publike.

Ne besojmë se ky mekanizëm, kjo lidhje, ky korrelacion, ndihmon më shumë ligjshmërinë e veprimtarisë së administratës zgjedhore, dhe besojmë se këtë do ta tregojë në të ardhmen, në qoftë se ju e pranoni, në qoftë se kjo do të implementohet, se ka për të ndryshuar rrënjësisht mënyrën e sjelljes.

Për të shkuar te pjesa e kësaj pakete amendamentesh, por edhe te shqetësimi i zotit Murrizi, do të thosha se administrata zgjedhore është konceptuar të funksionojë si e tillë, pra sipas kësaj skeme, pavarësisht nëse votimet në Shqipëri apo numërimi i votave do të jetë manuale apo elektronike. Kjo skemë e ka dhënë përgjigjen për të dyja llojet e votimit. Rregullat bazë dhe garancitë i ka të sanksionuara në këtë skemë, për aq sa i takon kuadrit ligjor, sepse procedurat e votimit elektronik apo të numërimit manual në shumicën e tyre, për nga natyra, dispozitat e akteve nënligjore nuk janë dispozitat e një ligji. Ne kemi dhënë

minimumin e nevojshëm, si: garancitë ligjore për sistemet se si do të funksionojnë, tagrat, të drejtat, detyrimet dhe kufizimet e Komisionit Zgjedhor të zgjedhjeve, në raport me një të tjetër apo tjetër procedurë.

Në këtë prezantim, unë nuk do të ndalem, siç tha bashkëkryetari, te formulimet konkrete, sepse ju i keni, por mendova që këto janë elementet më të rëndësishëm.

Dua të them një fjali që e kisha harruar, por që gjykoj se është e domosdoshme, paketa ka në fund amendamentet te ligji i nëpunësit civil. Mund të ketë debat nëse janë objekti i punës apo jo ato amendamente. Minimalisht duhet të ketë një vetëdije që pa amendamentet, te ligji i nëpunësit civil, skema nuk është më e sigurt. Kjo do të thotë që ju, minimalisht, duhet t'i shqyrtoni këto amendamente. Nëse pranoni këtë skemë, atëherë duhet të pranoni edhe ato amendamente, te ligji i nëpunësit civil, sepse skema nuk funksionon dot dhe bien garancitë që administrata zgjedhore të funksionojë në zbatim të ligjit. Pra ikën kapitulli i përgjegjësive dhe i dhënies së llogarisë, prandaj duhet t'i shikoni bashkë. Nëse e gjykoni t'i miratoni, pastaj procedurat e brendshme parlamentare mund t'ia kaloni Komisionit të Ligjeve për ta ndjekur, por ju duhet t'i shqyrtoni dhe duhet të shpreheni të bindur për këtë.

**Damian Gjoknuri** – Po, mund ta bëni pyetjen.

**Ralf Gjoni** – Faleminderit!

Unë nuk kam pasur kohë të informohem mjaftueshëm dhe të punoj mbi këtë draft që të kem disa opinione të shëndosha në mendjen time. Më vjen turp, si anëtar i këtij komisioni ta marr vesh për draftin nga mediat, përpara se të na vinte dje me *email*. Këtë e kam si shqetësim për të dy bashkëkryetarët.

Me kolegët socialit kemi kërkuar, më duket se zoti Fino apo zonja Hysi ka kërkuar, në një nga mbledhjet e mëparshme, që draftet për diskutim të dërgoheshin disa ditë përpara, në mënyrë që ne të kemi mundësi të diskutojmë në mënyrë substanciale. Ndërsa tani na paraqitet një draft me ndryshimet thelbësore në krahasim me atë që kemi sot.

Pyetja ime për ekspertët është: cila është metodologjia që keni ndjekur në hartimin e këtij drafti? Me sa e pashë përciptazi këtë draft, sepse do të më duhet ta shikoj në detaje, ju propozoni një arkitekturë të re të administratës zgjedhore. Kjo është një gjë shumë e mirë, sepse ne na duhet kjo arkitekturë, por, nga leximi paraprak, mua nuk më duket si i depolitizuar, sepse shikoj që KQZ-ja përbëhet nga 1 komisioner shtetëror i zgjedhjeve, i zgjedhur nga Kuvendi për një mandat 7 vjeçar, 5 anëtarë të Komisionit Rregullator me mandat 5-vjeçar, të zgjedhur po nga Kuvendi me 84 vota dhe 3 anëtarë nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve që zgjidhen nga Kuvendi me një mandat 9-vjeçar. Pra,

zgjidhen 9 anëtarë që kanë një përplasje në kohëzgjatjen e mandateve në këtë KQZ. Që të flasim hapur, maxhoranca i ka 84 vota, prandaj nuk më duket e depolitizuar, por më duket më shumë e politizuar se administrata aktuale.

Unë rolin tuaj si ekspert e shikoj në reflektimin e rekomandimeve të ODIHR-it, por këto nuk janë rekomandimet e ODIHR-it, sepse ai ka rekomanduar depolitizimin e administratës. Mënyrën se si do të depolitizohet, në botëkuptimin tim politik, e kisha kuptuar që kjo do të diskutohej mes anëtarëve, por jo bazuar mbi një draft paraprak, pra të diskutohej për mënyrën se si mund të depolitizohet dhe pastaj bashkërisht me kolegët socialist, që kanë shumë eksperiencë në administrimin e zgjedhjeve, mund t'ju kërkonim dhe t'ju mandatonim ju si ekspertë që të punoni në këtë drejtim.

Çfarë keni bërë ju? Ju keni shkuar në një drejtim të caktuar, propozoni një arkitekturë totalisht të re, të cilën unë nuk e di se nga e keni marrë dhe si keni arritur në këtë arkitekturë. Unë nuk besoj se kjo arkitekturë duhet të jetë vetëm një propozim dy ekspertëve, por duhet të ketë një dakordësi më e përgjithshme me përplasje debatesh, mendimesh dhe eksperiencash. Pra dua të di se çfarë metodologjie keni ndjekur për të mbërritur në këtë arkitekturë.

Të nderuar bashkëkryetarë, përse materiali na dërgohet 1 ditë përpara? Më vjen keq, por kjo nuk është as normale dhe as profesionale.

**Damian Gjikhuri** – Do të përgjigjem për metodologjinë e ndjekur, e parë nga pikëpamja e komisionit dhe nisur nga eksperiencat e vazhdueshme jo vetëm të këtij komisioni, sepse ky nuk është komisioni i parë i ngritur në Republikën e Shqipërisë, por mbase nuk keni dëshirë t'i referoheni asaj të kaluar, por nga çdo eksperiencë legjislativë. Ka një parim, nëse ne do të rrahim ide dhe do të diskutojmë, se cila do të jetë zgjidhja më e mirë pa pasur një ide konkrete, kjo do të bëjë që: e para, ne nuk do të realizojmë asgjë.

E dyta, draftimi ka një parim, siç është edhe ekzekutimi në këtë rast, po marr rastin e qeverisë që bën projektligje, i sjell ato në Kuvend, por ka një grup ekspertësh, në këtë rast janë ekspertët pjesa jonë ekzekutive, që nisur nga adresimet e rekomandimeve të OSBE-ODIHR-it vjen me një propozim. Që të jemi të qartë, kjo nuk do të thotë se çfarë është shkruar këtu ne do ta pranojmë, ky është fillimi i diskutimit, ama ne ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Duro një sekondë, sepse nuk ka formë tjetër. Pra nëse ka propozime mund të themi që nuk jemi dakord me këtë formulë KQZ-je, pra ne hyjmë automatikisht në debat, ashtu siç hyjmë edhe për komisionerin zgjedhor. Ama ne duhet të kemi një pikë ku të fillojmë diskutimin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Do të japin...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në sekondë, se thashë për pjesën e metodologjisë se si komunikon komisioni me ekspertët. Për sa i përket kohës, 24 orë përpara mendoj se ka qenë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të lutem, 24 orë para është dërguar. Megjithatë, mos keni asnjë merak...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Një sekondë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Gjoni, mediat kanë forma të ndryshme për marrjen e informacionit dhe mund ta kenë marrë në momentin që u është shpërndarë deputetëve me *email*, pra e kanë marrë nga njëri nga ne. Çështja e sekretit të materialeve ka dështuar edhe në vende të tjera dhe jo më në një draft të komisionit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ta mbaroj. Nuk do të merrem me faktin nga e mori media, sepse nuk e kam ndjekur, megjithatë ky është fillimi i diskutimit prandaj mos keni asnjë merak. Ne nuk do të ngremë tani kartonat dhe të themi jemi apo jo dakord me këtë propozim, sepse kjo punë nuk shkon, pra ky është fillimi i diskutimit. Le të na japin racionalen nga se janë nisur, ne do të gjykojmë nëse janë adresuar si duhet rekomandimet e ODIHIR-it për depolitizimin në këtë formë, nëse ka ide të tjera më interesante patjetër që do të bëjmë propozime në lidhje me këtë draft. Pra, nuk është se drafti kaloi, ky është fillimi i diskutimit dhe diskutimi fillon gjithmonë nga një pikë, sepse nuk mund të zhvillohet në eter dhe secili të vijë me ide, se dikush duhet t'i shkruaj këto ide, pra nuk funksionon kështu.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kjo e kohës mund të korrigjohet dhe shikohet, mbase zonja Rudina mund të japë...

**Ralf Gjoni** – ... *(flet pa mikrofon)* ... disa ditësh si bashkëkryetarë Unë mendoj se do të ishte në dinjitetin tonë si kolegë deputetë, sepse as zonja Hajdari dhe as zoti Gjijnuri nuk janë pronarë të këtij komisioni, por janë atje me vullnetin tonë si përfaqësues të mazhoracës dhe opozitës, për këtë besoj se bien dakord edhe kolegët socialist, si zoti Fino dhe zonja Hysi që është shumë tërësore në analizën që i bën drafteve, që ta kishim draftin 2 – 3 ditë përpara. Përse nuk na e keni dërguar më përpara, kjo nuk më duket normale?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kjo ka të bëjë me metodologjinë e punës në këtë komision, zoti Fino.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Rudina Hajdari** – Unë besoj se të gjitha kritikak që thatë në lidhje me kohën janë me vend dhe kjo është një gjë që duhet marrë parasysh nga sekretaria. Kjo çështje është shumë e rëndësishme prandaj ne do të kemi edhe një seancë tjetër në lidhje me këtë temë, në mënyrë që t'i japim vetes kohë nëpërmjet kompromisit...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Gjoni, sot do të dëgjojmë vetëm prezantimin thjeshtë për të marrë një ide se çfarë kanë arritur ekspertët...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

A mund të mbaroj? Të lutem, se të kemi respektuar, të kemi dhënë fjalën dhe po i marrim parasysh të gjitha kritikak edhe pse drejtove gishtin, prandaj të flas edhe unë. Po të them edhe një herë, që unë përfaqësoj vullnetin e opozitës dhe kjo nuk ka asnjë dyshim, prandaj as ti nuk duhet ta vësh në dyshim këtë pjesë, por sot do të bëhet thjeshtë një prezantim nga ekspertët. Jam dakord që çdo gjë, që do të thuhet nga opozita dhe nga mazhoranca në lidhje me këtë propozim, duhet të marret parasysh. Ne nuk na ndalon asnjë të merremi me këtë draft, t'ua çojmë ekspertëve të tjerë apo OSBE – ODIHR-it, pra të gjithë personave që ne mendojmë se janë më të besueshëm se ekspertët që janë këtu. Kjo është çështje...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E kam fjalën, që është në dorën tonë ta bëjmë këtë gjë. Unë nuk e di përse vazhdon të rrjedhë informacioni nga zyrat e Kuvendit, kjo dodh vazhdimisht. Pra nuk ka përse informacionet t'i marrim nga lajmet...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Damian Gjikhuri** – Ju lutem, mos u shqetësoni...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Rudina Hajdari** – Patjetër, prandaj ekspertët janë këtu, por unë iu përgjigja shqetësimit tënd në lidhje me kohën që ishte i drejtë dhe me vend. Kaq.

Të biem dakord me bashkëkryetarin që të bëjmë edhe një seancë tjetër, në mënyrë që të gjithë anëtarët të kenë kohë ta lexojnë me hollësi të gjithë draftin dhe pastaj të vijmë me pyetje, komente, amendime e të tjera.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Damian Gjikhuri** – Zoti Fino, për procedurë.

**Bashkim Fino** – Ralfi thotë që drafti ka ardhur me vonesë, mund të ketë të drejtë, sepse ka ardhur dje në drekë dhe ndoshta nuk ka pasur kohë, mund të ketë pasur angazhime të tjera politike, por ndërkohë bën edhe pyetje. Kjo do të thotë se e ka “përtypur” atë që tha zoti Rusmali...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të lutem, pra me aq sa kishte mundësi e ka “përtypur” diçka dhe i jep vetes mundësi për të bërë pyetje. Unë jam me atë që tha zonja Hajdari, që normalisht drafti mund të vijë edhe më shpejt dhe duhet të vijë, por në rastin konkret sot na u bë një ekspozë. Zoti Gjoni, edhe unë sot e pashë për herë të parë, ndërkohë që po fliste Rusmali unë po e lexoja draftin dhe më shpëtuan disa paragrafë shumë interesante, që tha zoti Rusmali, të cilët nuk duhet të shpëtojnë, por isha i detyruar të lexoja për të ditur se çfarë thuhej për ca gjëra teknike.

Problemi është që ne kemi një draft, për të cilin edhe ne mund të bëjmë disa pyetje dhe sugjerime dhe ta lëmë këtu që të vazhdojmë në një seancë tjetër. Këtë e kam për ju personalisht, por edhe për grupin tuaj të opozitës që mund të bini një ide tjetër për depolitizimin e administratës...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mund të sillni një ide apo draft tjetër ku të thoni: “Depolitizimin e administratës unë nuk e shikoj me këtë metodologji që keni punuar ju, por e shikoj në një formë tjetër”. Ne këtu pastaj do ta diskutojmë se si do e bëjmë, ta bëjmë kështu apo ashtu. Ndërkohë ne kemi një draft, i cili na jep mundësi të bëjmë pyetje, ashtu siç bëre ti pyetjen e parë dhe me siguri që përgjigjet do të fillojnë me pyetjen tuaj, prandaj të bëjmë edhe ne ca pyetje për këtë draft dhe ta lëmë të hapur për diskutim. As mua, që jam anëtar i mazhorancës, nuk më ka marrë njeri mendim për këtë draft, por unë do ta dëgjoj. Nëse më pëlqen do të them dakord, nëse nuk më pëlqen do të them ndonjë mendim tim. Prandaj mos u bëj kontradiktor me veten tënde. Mbledhja filloi dhe duhet të vazhdojë. Ti e bëre pyetjen tënde, të vazhdojmë më tej...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, për këtë e kisha edhe unë.

**Damian Gjikhuri** – Dua të bëj një propozim, përpara se të flasë eksperti. Meqenëse ka nevojë për më shumë kohë, të biem dakord me njëri-tjetrin që të drejtojmë të gjitha pyetjet që kemi, ekspertët t’i marrin shënim dhe seancën tjetër të vijnë me përgjigje, që të jemi racional. Ndërkohë edhe ne të jemi më të qartë për draftin...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, prandaj po them.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë pa e parë kam shumë pyetje...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Një sekondë, e dyta, pyetjet mund t'i dërgojmë edhe me shkrim.

E treta, edhe në seancën tjetër mund të bëjmë pyetje, pra nuk mbaruam, nuk do të ikim me vrap.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Për metodologjinë do të përgjigjet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ralf Gjoni** – Idea është e tillë, ne a do ta marrim të mirëqenë këtë arkitekturë dhe do të punojmë mbi këtë, sepse zoti Gjiknuri me të drejtë thotë që të bëjmë pyetje...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Adriatik, më fal, të lutem. Pra, ne do të bëjmë pyetje mbi këtë arkitekturë, sepse zoti Fino me të drejtë thotë që mund të kemi edhe një arkitekturë tjetër? Nuk më takon mua të shkruaj drafte, kur u takon ekspertëve. Për shembull, nëse do të na merrej mendimi, propozimi imi do të ishte: një KQZ që del nga vetingu i gjyqësorit, ky propozim është si në Rumani, me një administratë totalisht të depolitizuar, me një short përzgjedhës të anëtarëve të komisioneve që do të numërojnë votat dhe me numërim atje ku votohet. Pra, po jua jap arkitekturën time dhe nuk e kuptoj përse të mos merret kjo arkitekturë që po propozoj tani dhe të bëjmë pyetje mbi një draft të ri të punuar mbi një arkitekturë tjetër, por të bëjmë pyetje mbi këtë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pra, si keni mbërritur ju në këtë arkitekturë që kemi përpara?

Faleminderit!

**Damian Gjiknuri** –Unë po ju them që të gjithë ne këtu mbi këtë draft kemi të drejtë të bëjmë propozimet tona. Kjo do të thotë që ky draft bie, sepse kur flitet për KQZ-në, ka një nen përkatës. Pra, ti do të dalësh me formulën që thua, që anëtarët do t'i zgjedh gjyqësori, do të bëjmë veting e të tjera, pra do të vish me propozime konkrete apo me ide, që, nëse ne të gjithë do të biem dakord që kjo do të jetë idea, natyrshëm që do ta japim si detyrë ta zbardhin.

Zoti Rusmali, ju lutem, përgjigjuni përse jeni nisur me këtë propozim? Ju thatë diçka, por përsëri ka nevojë të sqarohet, por shumë shkurt. Pastaj secili nga ne të marrë kohën e tij për pyetjet, që t'i mbledhim dhe pastaj në seancën tjetër do të marrim përgjigjet dhe do të



bëjmë edhe pyetje të tjera. Nuk ka përse të mos evitojmë edhe mundësinë e pyetjeve në formë elektronike për t'ia drejtuar ekspertëve.

Fjalën e ka Iliri dhe pastaj fillojmë me pyetjet.

Po, Ilir.

**Ilir Rusmali** – Faleminderit, zoti bashkëkryetar!

Unë besoj se ju niseni nga qëllimi i mirë kur më thoni që të kufizohem në përgjigje, sepse doni të më lehtësoni barrën, por unë besoj se nga ana jonë, disa informacione faktuale është mirë të jepen, sepse krijohet perceptimi i gabuar te anëtarët e komisionit dhe ndër të tjera e vuajmë edhe ne si ekspert në këtë punë duke u përfshirë në debatin politik në mënyrë të panevojshëm.

Dua të filloj me një gjë që nuk ka lidhje me kërkesën tuaj për këtë përkufizim. Ne jemi *si si* në komunikimin që bën sekretaria e komisionit me anëtarët e komisionit. Unë mund t'ju informoj që sekretaria ka shpërndarë draftin te anëtarët e komisionit vetëm 30 minuta mbasi ne mbaruam punën tonë, kjo mund të verifikohet edhe në dokumentacion. Ne kemi dërguar raportin shpjegues 30 minuta përpara se materiali t'u shpërndahej. Kjo do të thotë se materiali nuk është dërguar me vonesë, sepse 30 minuta nuk është vonesë, evetualisht mbledhja është organizuar shumë shpejt, por kjo është çështje juaja. Pra nuk dua që të ketë perceptim të gabuar për faktet, sepse këto janë faktet dhe është mirë që t'i dimë.

Lidhur me arkitekturën që ne propozojmë, shumë shkurt, në parantezë po ju them se na është kërkuar, pra është kërkuar dhe nuk e kemi imagjinuar, që të sjellim amendamente për administratën zgjedhore në zbatim të rekomandimit bazë për depolitizimin. Kjo na është kërkuar dhe nuk e kemi bërë me iniciativën tonë, sepse edhe si tipa nuk jemi shumë të zedhshëm as unë dhe as Viktori. Viktori është ende, i ka ca, por unë nuk i kam, se i kam hequr, nuk jam shumë i zellshëm, por më është kërkuar të bëj detyrën dhe e kam bërë.

Le të flasim pak më gjerë, të flasim për modelin, pastaj për arkitekturën, se mund të jenë sinonime të njëra tjetrës, por nuk janë krejtësisht të përputhshme. Ka vetëm tri modele për mënyrën si organizohet një administratë zgjedhore: modeli politik i administratës zgjedhore, është modeli shtetëror i administratës zgjedhore dhe modeli i pavarur neutral i administratës zgjedhore. Ne nuk kemi pasur alternativë për të zgjedhur modelin, sepse për ne ka qenë jashtë çdo lloj imagjinate që të vinim këtu me propozimin që administrata zgjedhore duhet të jetë kompetencë, detyrë dhe funksion i ekzekutivit. Ne kemi eksploruar vetëm një model, modelin e pavarur të organizimit të administratës zgjedhore.

Arkitektura që kemi propozuar mbështetet në studimin dhe analizën e fenomenologjisë shqiptare, ne jemi të gjithë njerëz që kemi eksperiencë me zgjedhjet, e dimë se ku çalon puna, i dimë se ku janë problemet dhe jemi përpjekur t'u japim zgjidhje në masë (ne besojmë 100%, por ju mund të keni ende dyshime dhe mund të na korrigjoni), shqetësimeve të shqiptarëve.

E treta, modeli që ju propozojmë është 100% i depolitizuar sipas të gjitha rregullave të zanatit dhe kjo është jashtë çdo lloj debati. I depolitizuar do të thotë se partitë politike nuk kanë të drejtë të propozojnë, të emërojnë dhe as të shkarkojnë, prandaj kjo e bën 100% të depolitizuar. Me të gjithë respektin absolut për të gjithë anëtarët e komisionit, jam i detyruar ta them, nuk po përballem me opinionet tuaja, se fakti që kompetencën për emërimin e komponentëve të KQZ-së e ka parlamenti nuk e bën politik KQZ-në, zero. Kompetencën e propozimit e kanë, përtej atyre që vetofrohen për t'u bërë anëtarë të KQZ-së, e ka çdo deputet dhe pavarësisht nga fakti që është funksionar politik, nuk e bën politike të drejtën e propozimit. Deputeti e ushtron këtë kompetencë në funksion të tagrave të veta si përfaqësues i popullit, jo në funksion të tagrave të veta si anëtar i kryesisë së partisë, i asamblesë apo i Këshillit Kombëtar. Vetë parlamenti, pavarësisht se ju mundoheni të bëni debat për këtë, në doktrinën juridike nuk quhet organ politik, nuk është politik, por organi më i lartë ligjvënës, është pushtet, jo organ politik, pavarësisht se roli i partive politike brenda parlamentit është shumë i madh. Nuk është kjo që e bën atë organ politik. Kjo do të thotë se fakti që përzgjedhja i lihet në dorë parlamentit, nuk ka farë të bëjë me pavarësinë e tij, nuk e cenon pavarësinë e tij.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Damian Gjijnuri** – Nuk është momenti për të bërë debate, por të dëgjojmë dhe të bëni pyetje.

**Ilir Rusmaili** – Është terminologji i doktrinës juridike, pavarësisht se në praktikë jemi mësuar dhe e kemi shumë komode të themi se maxhoranca është PS-ja ose, eventualisht, PD-ja. Maxhoranca është trupa e brendshme parlamentare, që merr vendime sipas vullnetit të vet, nuk shihet partia mbrapa maxhorancës, por shihet trupa që është brenda parlamentit. Unë nuk operoj dot në doktrinën juridike me konceptin politik, jam i detyruar të operoj me konceptin juridik dhe besoj se në këtë kuadër, fakti që mekanizmi i përzgjedhjes kërkon 3/5-at e votave, ose eventualisht shortin, është mekanizmi *par excellence* i pavarësisë.

Nëse futesh në modele, në doktrina dhe të thonë “Na jep një strukturë ligjore të pavarur!” fut dorën në xhep dhe nxjerr 3/5-at, se nuk ke çfarë të nxjerrësh tjetër, fut dorën në

xhep dhe nxjerr shortin, se nuk ke çfarë nxjerr tjetër (këto japin pavarësinë), fut dorën në xhep dhe nxjerr pamundësinë e organit emërtues ta shkarkojë individin, fut dorën në xhep dhe nxjerr garancinë e pagës. Këto janë mekanizmat që njeh doktrina juridike dhe teknika legjislative. Ne kemi përdorur të gjitha elementet juridike që garantojnë pavarësinë në doktrinën juridike, i kemi marrë dhe i kemi grumbulluar.

Argumenti tjetër ka gjithashtu lidhje me pavarësinë. Ne kemi dashur që me modelin e përzgjedhjes dhe emërimit të KQZ-së t'i përafrohemi dhe të harmonizojmë me praktikën aktuale parlamentare përzgjedhjen dhe emërimin e institucioneve të pavarura në Shqipëri. Kemi pyetur si zgjidhen institucionet e pavarura në Shqipëri? Zgjidhen me modele të ngjashme me këtë që po propozojmë ne, zgjidhen nga parlamenti. Sot i kemi në fuqi dhe të pavarura. Ajo që kemi shtuar më shumë është doemos mekanizmi i 3/5-ave, sepse ky është kyç për garantimin e pavarësisë. Ju mund ta hiqni apo ta shtoni, jeni të lirë, por shumica e cilësuar është kyç.

Çështja e fundit, që ka lidhje me këtë. Ju thoni me të drejtë se në konfigurimin aktual maxhoranca i ka 3/5-at, nuk e ka problem, se i cakton vetë. Unë, si ekspert, apo Viktori, nuk operojmë dot me këtë kategori. Cila është kategoria juridike që jep pavarësinë? Shumica e cilësuar. Por edhe ju duhet të merrni minimalisht në konsideratë faktin që këto amendamente nuk bëhen për zgjedhjet që do të vijnë. Ju keni përpara nevojën për të diskutuar si do të bëhet për zgjedhjet që do të vijnë, por kjo është temë tjetër, nuk është pjesë e detyrës, ne mund ta gjejmë zgjidhjen edhe për zgjedhjet e ardhshme, por nuk është pjesë e detyrës sonë. Kjo është e mundshme për zgjedhjet e 30 vjetëve të ardhshme, jo për zgjedhjet që vijnë. Ne duhet të imagjinojmë dhe konfigurojmë një mekanizëm që i reziston kohës dhe jo një mekanizëm që i reziston konfigurimit aktual. Mekanizmi për konfigurimin aktual është tranzitor, ju mund ta gjeni vetë, sepse jeni të gjithë në komunikim me njëri-tjetrin (kjo është konsiderate politike). Nëse do të na e ngarkoni neve, mund t'ju sugjerojmë variante të ndryshme për të gjithë situatën aktuale, por nuk ka lidhje ky lloj diskutimi racional me arkitekturën që ne i kemi dhënë, sepse arkitektura jonë është projektuar në harkun e 30 e më shumë vjetëve. Ne synojmë që kjo t'i rezistojë kohës, sepse besimi ynë i palëkundur është që Shqipëria në fushën e demokracisë nuk bën do më përpara, ka ngecur në vend në radhë të parë se kuadri ligjor po e pengon. Ne e ndryshojmë kuadrin ligjor me qëllim që Shqipëria të avancojë, proceset pastaj janë të gjitha politike, janë tuajat, i zgjidhni me njëri-tjetrin në konsulta, në negociata, apo në debate me njëri-tjetrin, ku me siguri mund të gjeni zgjidhje shumë të mira

për konfigurimin aktual, por për të ardhmen ky është shumë i mirë dhe ne besojmë vërtet se është një mekanizëm shumë solid dhe që do të sjellë përmirësime të jashtëzakonshme.

**Damian Gjicknuri** – Faleminderit!

Tani le të fillojmë me pyetjet!

Zoti Hyseni në fillim.

**Alket Hyseni** – Faleminderit, të nderuar bashkëkryetarë!

Së pari, proceduralisht, ne kërkojmë tabelën. Ju lutem, materialin që dorëzoni, do të donim ta bënim me tabelë, aty ku ka ndryshime! Kuptohet që kjo është një paketë e re, por në përgjithësi kërkohet tabela, që të gjithë deputetët të orientohen ku jemi, çfarë do të bëjmë, por edhe rekomandimet. Siç e kemi nisur me pjesën e parë, jemi shumë mirë.

Unë kam disa pyetje. Çështja a do të ndjekim apo jo këtë rrugë kjo është për t'u parë, pavarësisht modelit. Ju keni përcaktuar kriteret, të cilat kanë të bëjnë me ish-gjyqtarët. A mos bie shumë ndesh kjo me faktin e vetingut, sepse me termin “ish-gjyqtar”, pavarësisht se ligji i vetingut thotë që nuk kanë funksione, sillet në opinion një problematikë apo një debat. Cilët janë ata ish-gjyqtarë që nuk qenkan gjyqtarë dhe paskan ikur? Mund të jenë me kokrra, mund të mos futet si kategori. Ju thoni ish-funksionarë politikë, pra ua jepni ish-funksionarëve, por jo funksionarëve politikë. Kjo shoqëria jonë sa paska prodhuar? Duhet të dini se shumica e intelektualëve me vlera janë futur në politikë dhe nëse ne i bëjmë të gjithë këta me zero, do të na ndodhë siç po na ndodh me institucionet e drejtësisë, ku nuk ka më aplikantë, por shkojnë njerëz që nuk janë dinjitozë për atje, dhe këtë e dimë të gjithë.

Kujdes me kriteret! Keni hequr pedagogët e universiteteve. Nuk vlejné ata për ju si kriter? Këto janë pyetje prandaj mbajini shënim, nuk i duam sot, se nuk ia dalim dot, kështu që herën tjetër, por po flas në përgjithësi për kriteret, se i kam shqetësim dhe dua që të mbahen shënim.

Statusi që i jepe, statusi i Gjykatës së Lartë, komisioner është, të mbahet logjika edhe e komisionerëve të tjerë dhe e vendeve të tjera...anëtari i Gjykatës Kushtetuese ka praktika, besoj unë...

**Vasilika Hysi** – Me kryetarin e Gjykatës Kushtetuese.

**Alket Hyseni** – Ju e keni bërë me kryetarin, por është një frikë se duket sikur disa kriterë janë vënë për të zgjedhur emra, sikur po ngushtohet rrezja dhe e dimë që me këto 3 kriterë, 20 vetë janë në treg, të cilët do të aplikojnë dhe do të zgjidhen, por nga këto 20, 10 janë institucione, 5 atje e 3 atje.

Kam një pyetje teknike. Mandatet i keni bërë të ndryshme dhe unë e kuptoj, por mundohuni të na sqaroni si komision se cili është qëllimi, që të mos ketë koherencë me një fushatë. Pse keni zgjedhur pikërisht këtë klasifikim, pra 5, 7 dhe 9?

Në lidhje me procedurat e votimit jashtë vendit, mendoj se jeni nxituar. Ky komision ka ngritur grupe pune, ku jam unë, kolegu Adnori dhe dy kolegë të opozitës, nuk ka zero konsulencë. Kështu që për këtë pikë le të ulemi e të punojmë, përndryshe përse janë grupet e punës? Ju jeni vënë në dijeni si ekspertë që janë tri grupe pune. Jeni marrë me sistemin dhe e di që keni bashkëpunuar me kolegët, por me çështjen e votimit jashtë vendit nuk jemi konsultuar, jo se ju do ta bëni anën teknike, por është mirë të bashkëpunojmë. Prandaj propozoj që grupi i punës dhe ekspertët të lënë një mbledhje para mbledhjes tjetër. E bëj këtë sugjerim meqë jemi tek ai grup.

Zyrtarët zgjedhorë.

E keni lënë me aplikim, por mund të dështojmë, prandaj duhet bërë me detyrim. Shporta e madhe, siç e kanë praktikatat e vendeve të tjera, mbushet me detyrim. Po të jesh te shporta dhe ke kritere, të bëhet me detyrim, se e keni lënë me aplikim. Aplikojnë, themi ne, dhe po plotësuan kriteret marrin statusin dhe dëshminë. Po nuk aplikuan çfarë të bëjmë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, unë e lexova, por nuk është e qartë kur është me detyrim. Merakun e kam se shporta mbushet me detyrim pa aplikime, nga lista me short, pra ndërron skema. Këtu thuhet “detyrim, por me aplikim”, nuk ka edhe detyrim edhe aplikim, sepse janë dy nocione të ndryshme, aplikimi është vullnetar, detyrimi është nocion tjetër. Kështu që mendoj që shportën ta mbushim me detyrim, të seleksionojmë dhe të mbajmë në shportë 30% ose 50% më shumë, pastaj emërimet të bëhen nga Komisioni Qendror. Vetëm nëse personi jep dorëheqjen për shkaqe të arsyeshme, ose deklaron pamundësinë, hiqet fare nga shporta.

Këto janë pak a shumë çfarë doja të thosha, se nuk dua të ndalem më tepër. Kam edhe një vërejtje parimore. Emërtesat shqip. Po përdorni shpesh terma dhe formulime të huaja, ose huazime që ndoshta nuk janë ndër më të mirat. Pse duhet ta themi indirekt “personi që kandidon ose që propozohet për komisioner nuk përfshihet në listën e kandidatëve që votohen”? Ta themi “ndalohen”, se ato janë kritere ndaluese, nuk kemi pse ta themi si anglezët, se ata kanë një kulturë tjetër, ne do ta themi si mesdhetarë “ndalohet të kandidojnë 1, 2 apo 3...” Kjo është praktika jonë kushtetuese dhe ligjore dhe teknika legislative që ndjekim, kurse kështu ti thua që ai aplikon, bën një thes me letra dhe kur vjen puna për t’u

votuar themi “nuk lejohet”. Ta themi “ndalohet”, se edhe qytetari e di që ndalohet të aplikojë për këtë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dakord, qofsha i gabuar!

**Damian Gjikhuri** – A doni që disa pyetje të marrin tani përgjigje, apo t’i bëjmë të gjitha?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dakord.

Bashkim të lutem, se kam hallin e procedurës, se këtu thuhet fjalët, por mbeten në ajër.

I lutem sekretarisë që të gjitha pyetjet që do të bëhen sot t’i zbardhë dhe procesverbali vetëm me pyetjet do t’u çohet ekspertëve dhe të gjithë anëtarëve me *e-mail*, me qëllim që të dihet se çfarë pyetjesh janë bërë. Të bëhet kjo punë sot, se është nuk duhet lënë në ajër, se jo të gjitha mbahen shënim, pasi është vendimtare.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

A doni të vazhdojmë pyetje-përgjigje? Dakord

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Gjoni, zoti Bashkim, ju lutem!

Këtu ka një grup anëtarësh që duan më shumë kohë dhe një grup tjetër që janë gati. Unë propozoj që ata që bëjnë pyetje, le të vazhdojnë me përgjigjet, pjesa tjetër të bëjë pyetje të tjera dhe, radhës tjetër, t’i nisë me shkrim që t’i dimë të gjithë.

Filloni zoti Ilir me pyetjet që u ngritën për pjesën e komisionerëve dhe për skemën, pa pjesët e redaktimeve, se do t’i rregullojmë rrugës.

**Blerina Gjylameti** – Më falni kryetar, e kam për procedure!

Ramë dakord që pyetjet do t’i ngremë dhe një pjesë do t’i mbajmë shënim, por nëse do të na lindin pyetje të tjera, do t’jua nisim me shkrim ose do t’jua bëjmë gjatë seancës, përse kthehemi pas?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk e kam mbaruar, zoti Gjikhuri.

Të gjithë kemi ndër mend të vazhdojmë me pyetjet, nëse do të marrim përgjigje vetëm për pyetjet e zotit Hyseni, të jeni të bindur që seanca përfundon këtu, sepse nuk mund të vazhdojmë 7 orë, që do të thotë, më mirë të dëgjojnë, se pyetjet mund të përsëriten, dhe më

pas bëjmë një seancë tjetër ku gjithsecili ta këtë analizuar mirë draftin, se disa kanë krijuar një mendim e disa një tjetër. Unë them të mos i rikthehemi një vendimmarrje të marrë.

Faleminderit!

**Damian Gjikhuri** – Kush është dakord të bëjmë vetëm pyetje tani dhe të vazhdojmë me metodologjinë që thashë? A do të qarkullohen të gjitha pyetjet me *e-mail* dhe seanca tjetër të jetë për përgjigjet?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Shumica është dakord.

Atëherë pyetja tjetër.

Do të bëhet me votim, se nuk mund të mbaj debat, komisioni ka rregullore dhe shumica vendos.

Zoti Nimet, vazhdoni me pyetjen tjetër!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

U hodh në votim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të lutem, një sekondë, zoti Alimadhi, sepse ne kemi mendime të ndryshme për këtë.

**Adriatik Alimadhi** – Sepse ju rendni pas një ...

**Damian Gjikhuri** - Unë nuk rend, por e hodha në votim. A e doni me shumicë, apo do të vazhdojmë kështu?! Si doni ta bëjmë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Këtu, në këtë tavolinë, ju jeni shumica, kurse ne jemi pakicë sot, sepse kemi më pak. Atëherë, ju bëni si të doni, unë e hodha në votim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ky kërkon kohë, ai tjetri kërkon kohë, çfarë t'ju them unë tani juve!

**Rudina Hajdari** – Kjo çështja për kohën...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Më falni, zoti Alimadhi, unë ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Gjoni dhe zoti Alimadhi, a mund të flas një sekondë?

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ne kemi ezauruar gati 10 minuta kohë vetëm duke debatuar.

Së pari, ajo që tha zoti Alimadhi është e drejtë dhe nuk ka absolutisht asgjë të keqe. Pra, edhe ata, të cilët nuk e kanë lexuar draftin, mund të dëgjojnë përgjigjet e pyetjeve, sepse,

kur ta lexojnë, do ta kenë më shumë idenë se çfarë po lexojnë. Kështu edhe për pyetjet mund të kenë ide më të mira, sepse nuk do të kenë nevojë që të bëjnë të njëjtat pyetje në mbledhjen e ardhshme. Pra, këtu nuk shikoj asgjë të keqe.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Damian Gjikhuri** – Atëherë, do të bëjmë një marrëveshje që të vazhdojmë me pyetje-përgjigje deri në orën 13:30 dhe më pas e ndërpresim.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Pra, po e bëj këtë propozim me kompromis, që të vazhdojmë me pyetje-përgjigje deri në orën 13:30 dhe më pas do të vazhdojmë me skemën tjetër.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Pra, do të vazhdojmë deri në orën 13:30 dhe më pas pjesa tjetër do të ngrejë pyetjet dhe do të kërkojë kohë.

Mund të vazhdoni, zoti Ilir, shumë shkurt lidhur me pyetjet që ngriti zoti Hyseni.

**Ilir Rusmali** – Për sa i përket pyetjes së parë, fakti që përmenden ish-gjyqtarët, dhe kjo kategori nuk lidhet me procesin e vetingut, duket sikur ka një kontradiktë brenda vetes. Ne gjykojmë se nuk ka kontradiktë ndërmjet termit “ish-gjyqtarë”, që ne përmendim këtu dhe procesit të vetingut, sepse, siç e thamë, ne nuk zgjedhim një kategori profesionale, por zgjedhim një kategori, e cila ka një CV nga pas. Në fakt, ne zgjedhim CV-në, jo kategorinë. Ish-gjyqtarët, të cilët ne i konsiderojmë kandidatura të mundshme për t’u propozuar, kanë eksperiencë të demonstruar dhe të provuar në jetën e tyre, si dhe gëzojnë një reputacion të lartë. Çfarë është në vetvete procesi i vetingut?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, nuk janë ashtu!

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ne kemi qenë shumë të vetëdijshëm dhe shumë këmbëngulës në përzgjedhjen e këtyre formulimeve. Gjithashtu, me këto formulime ne kemi dashur, së pari, të krijojmë një eksperiencë të re për parlamentin shqiptar, për ligjvënien në Shqipëri; një eksperiencë që heq dorë nga kriteret formale dhe kriteret jodomethënëse.

Kriteri formal përdoret rëndom në legjislacionin shqiptar, i cili përcakton 10 apo 15 vjet punë. Pra, ti mund të jesh edhe rezil, por të mjaftojnë 10 vjet punë që të kalosh, sepse i ke plotësuar kriteret.

Kriteri jodomethënës...

*(Diskutime pa mikrofon)*



Kriteri jodomethënës është kriteri që lidhet me profesionin, pra që të kesh një profesion të caktuar.

Kriteret i shpërbëjnë nevojës për të përzgjedhur më të mirët dhe më të mirët përzgjidhen nga CV-të e tyre, jo për shkak të kriterit formal. Prandaj, ne i kemi mëshuar fort pas çdo formulimi nevojës për të demonstruar dhe për të provuar. Kjo do të thotë se edhe heqja nga lista duhet të bëhet nëpërmjet nevojës për të demonstruar dhe për të provuar eksperiencën më të mirë për atë që propozohet.

Në rastin e rregullatorit ai duhet të jetë struktura që do të hartojë ligjet dhe aktet nënligjore të fushës, që do të thotë se anëtarët e rregullatorit duhet të jenë njerëz, të cilët të kenë demonstruar aftësinë e tyre se dinë të hartojnë dhe të miratojnë ligjet e fushës. Është krejtësisht normale që një anëtar rregullator të jetë një ish-deputet, i cili e ka mbyllur karrierën e tij si deputet, por që ka një eksperiencë të madhe në këtë punë.

**Alket Hyseni** – Kjo nuk ka lidhje fare!

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Ilir Rusmali** – Meqenëse gjëja u bë shumë personale ...

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Rudina Hajdari** – Zoti Hyseni, ai nuk do të japë përgjigjen që doni ju, por do të japë përgjigjen që di vetë. Më vjen keq tani, sepse ju i bëtë pyetjet me vend, por, nëse nuk ju pëlqen përgjigja, atëherë kjo është puna juaj.

**Ilir Rusmali** – Nuk kam arritur ende tek ajo pjesë dhe nuk kam frikë të jap përgjigjen, por, meqenëse po kalojmë në kontekst personal, unë personalisht dua t'i them deputetit Hyseni: uroj që ta keni jetën sa më të gjatë si deputet dhe të mos jeni kandidat i mundshëm për anëtar rregullator. Mund të merrni edhe poste më të larta, por jo të jesh kandidat për anëtar rregullator.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Damian Gjikhuri** - Zoti Ilir, ju tërheq vëmendjen, sepse nuk po bëjmë debate personale këtu. Ju do të përgjigjeni shkurt, kurse deputeti nuk do të bëjë debat. Këtë çështje do ta diskutojmë ne më pas se cili do të jetë versioni final, nëse do të biem dakord, kështu që fokusohuni te pyetja.

**Ilir Rusmali** – Atëherë, unë nuk kam lejuar horrat e Shqipërisë të cenojnë dinjitetin tim dhe nuk mund të lejoj as një njeri të cilin e respektoj dhe e konsideroj koleg.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Damian Gjikhuri** – Ilir, të lutem!

Zoti Hyseni, të lutem, ai nuk e ka personale.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Ilir Rusmali** – Ky vend ka shkuar deri në atë pikë sa ky popull i shikon deputetët si kriminelë për shkak të kësaj psikoze që përhapni ju; për shkak të kësaj sjelljeje që politika ndjek ndaj politikanëve, të cilët i quan të gjithë horra dhe nuk ka të drejtë ta bëjë. Unë kam ardhur këtu dhe me vetëdije kam bërë një propozim, i cili ju mbron ju dhe fytyrat tuaja. Ju më mirë thoni se ju pëlqen që të jetë ish-deputet, por të mos jetë i dënuar për vepra penale, sepse ju të tillë e doni deputetin, pra figura e tij të jetë pastër nga veprat penale. Deputeti ecën para me reputacionin e tij, me emrin e tij, me dinjitetin e tij, por ju, nëse doni...

**Damian Gjikhuri** – Zoti Ilir, mëni këto punë se u shprehët tani.

Zoti Viktor, mund të vazhdoni me pikën tjetër dhe fokusohuni te çështja.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Ilir Rusmali** – Jo, nuk duhet ta fyejmë njëri-tjetrin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pra, arsytimi ka lidhje me kriterin e plotë dhe jo me një pjesë të kriterit. Pra, jo me faktin që bëhet fjalë për ish-gjyqtarët, për ish-funksionarët apo për ish-drejtuesit e OJF-ve, por me faktin që këto kategori personash, të cilët duhet ta bëjnë skemën të funksionojë, duhet të kenë medoemos provueshmërinë e eksperiencës së mëparshme, një CV-i të suksesshme dhe reputacion në publik dhe kjo është e domosdoshme .

Pse janë “ish-a” dhe nuk janë aktualë? Kjo ka lidhje me një kriter tjetër, që për ne është shumë i rëndësishëm për funksionimin e kësaj strukture të pavarur, pra është jetik për funksionimin e strukturës së pavarur. Anëtarët e këtyre forumeve ne mund t’i përzgjedhim shumë të mirë, por mund të na korruptohen rrugës. Pse? Sepse funksionin e rëndësishëm që kanë për demokracinë këta njerëz, mund ta hedhin në pazar për interesat e tyre private dhe, nëse e bëjnë këtë, ata mund të korruptohen shumë lehtë. Në qoftë se ne do të merrnim një funksionar të lartë publik, një këshilltar ministri, një shef kabineti apo një nëpunës të lartë shtetëror, pra njerëz të këtyre niveleve, dhe do t’u besonim atyre këtë detyrë, praktikisht do të fusnim virusin te struktura, sepse këta njerëz nuk kanë interes primar të nxjerrin akte nënligjore, që rregullojnë fusha të tilla që të japin garanci tek të gjithë, por ata do t’u shërbejnë shefave të tyre që i komandojnë nga jashtë. Prandaj, ne kemi vënë kriterin që këta njerëz duhet të jenë “ish” dhe nuk duhet të kenë motive personale që t’i bëjnë ata vulnerabël ose, e thënë ndryshe, në momentin kur emërohen zbulohen motive personale, që i bëjnë ata vulnerabël, atëherë këto motive personale janë shkaqe të mjaftueshme për t’u thënë të

largohen se nuk e bëjnë dot detyrën. Gjithashtu, për pavarësinë në ushtrimin e funksioneve (kjo është domethënëse, nuk është as formale dhe as false) ka rëndësi fakti që të mos jetë i kapshëm dhe prandaj e kemi bërë të tillë.

Kriteret përtej asaj që duket dhe interpretohet si llaflollogji, si subjektive, si relative, si të pamatshme janë fiks e kundërta e tyre dhe ju jeni të vetëdijshëm për këtë gjë, sepse ju punoni me njerëz, i vlerësoni njerëzit, gjykoni për njerëzit dhe jeni më të mirët, të parët në këtë vend, që dini të gjykoni dhe të vlerësoni, jeni ata që përzgjidhni njerëzit me reputacion më mirë se kushdo tjetër. Kriteri nuk është relativ, është absolut, dhe nuk mund ta ngatërrojmë dot me vullnetin negativ, me keqdashjen kur i përzgjidhni. Në qoftë se ju do të përzgjidhni një njeri rezil, po e përdor përsëri këtë fjalë, nuk është faji i kriterit, është faji juaj që e keni përzgjedhur, sepse ju jeni të gjithë të zotë për të përzgjedhur më të mirin, ndaj ju takon juve ta zgjidhni të mirin dhe, me përgjegjësinë tuaj publike para popullit, duhet ta ushtroni me vetëdije të plotë këtë kompetencë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të lutem sepse është shumë e rëndësishme.

**Damian Gjijnuri** – Zoti Ilir, tani do të kalojmë...

**Ilir Rusmali** – Gjëja e mirë është se ky mekanizëm i jep të drejtën çdo deputeti, jo 20 deputetëve, jo një grupi parlamentar, pra i jep të drejtën çdo deputeti që në vetëdijen e tij të propozojë dhe të përzgjedhë kandidatët që ai gjykon se e realizojnë më mirë këtë funksion. Ky është një instrument shumë i fuqishëm në duart e deputetit. Unë mendoj se kjo është një garanci shumë madhe, që përzgjedhja do të jetë shumë e mirë.

Pyetja e dytë, mandatet janë të diversifikuar për tri strukturat. Unë besoj se mund të shpjegoj më shumë se sa ajo që vetë deputeti Hyseni tha në pyetjen e tij. Mandati i diferencuar është një formë e tërthortë e rotacionit. Mandati i diferencuar bëhet për të garantuar vazhdimësinë institucionale dhe jo më i rëndësishmi, por futet në listën e kriterëve që garantojnë pavarësinë e institucionit. Fakti që mandatet nuk lidhen me rotacionin politik, ne kemi gjykuar të jenë 5, 7 dhe 9 vjet. Ne e kemi ndarë në këtë formë, sepse ne besojmë se e tillë duhet të jetë jetëgjatësia. Trupat gjykuese administrative duhet ta kenë mandatin më të gjatë, sepse ata kanë detyrën më të vështirë për arsye se japin vendimet, që kanë efekte për fatin e zgjedhjeve. Prandaj, ata duhet të jenë më të mbrojtur, ndërsa trupa rregullatore duhet ta ketë mandatin më të ulët, sepse kuadri rregullator është një proces që, eventualisht, krijohet dhe shumë rrallë ka nevojë për t'u modifikuar, nuk ka nevojë të ndryshime pas çdo zgjedhjeje në qoftë se është i saktë, në qoftë se është solid, në qoftë se është i qëndrueshëm. Pra, ne

mendojmë se duhet të jetë kjo lloj ndarjeje, por qëllimi është ai që tha deputeti Hyseni që të garantojë atë gjë.

Ne jemi shprehur në mënyrë eksplicite për të drejtën e rizgjedhjes së komisionerit. Në qoftë se ju doni që të shprehemi në mënyrë eksplicite edhe për të tjerët, ne mund të shprehemi, por jemi nisur nga logjika që pavarësia e kastit garantohej me 9 vjet dhe, eventualisht, ta bësh anëtar të kastit 18 vjet, ndoshta mund të rezultojë jo shumë e leverdishme. Këta që e kanë 5 vjet konsiderohen që e kryejnë misionin brenda afatit, sepse plotësojnë kuadrin rregullator për 5 vjet. Ata, ndoshta, mund të kenë nevojë për ripërtëritje, sepse mund të kenë nevojë për mendime të reja, por, gjithsesi, në qoftë se ju gjykoni, ne mund të shprehemi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, ka një problem me rizgjedhjen, sepse jemi shprehur në mënyrë eksplicite për komisionerin, duke e përjashtuar nga rregulli që duhet të jetë një “ish”. Pra, ai që kandidon nuk duhet të jetë “ish”, por të jetë i palidhur me interesat materiale. Kjo është logjika, por, në qoftë se ju doni, ne mund ta shtojmë.

Lidhur me procedurat e votimit jashtë vendit, për shkak se ne kemi trajtuar administratën, dhe e kemi pasur të domosdoshme të trajtonim edhe kompetencat e KQZ-së. Pra, si dispozitat për teknologjinë, ashtu edhe kompetencat për votimin jashtë vendit i kemi parë vetëm nga këndvështrimi i kompetencës, jo nga këndvështrimi i procedurës. Kështu që në këtë kontekst ne absolutisht respektojmë funksionin që ka grupi i punës dhe jemi të vetëdijshëm për këtë funksion. Ndaj, ne nuk kemi dashur ta zhveshim grupin e punës nga detyra që ka, por kemi futur në ligj vetëm kompetencën që i duhet për t’u zhvilluar, me qëllim që të mos ketë nevojë ta ndryshojmë ligjin kur të bëhet aktiv votimi jashtë vendit apo teknologjia, ndërkohë që të gjitha procedurat janë për t’u hartuar. Ne nuk kemi asnjë dispozitë që ta thotë procedurën aty, përkundrazi themi që procedurat i takojnë dikujt tjetër ose një etape të mëvonshme. Sa i përket raportit të zyrtarëve zgjedhorë, nëse ata duhet ta ushtrojnë funksionin me detyrim apo duhet të aplikojnë, besoj se në formulimet tona kemi gjetur harmoninë e nevojshme midis detyrimit dhe aplikimit. Detyrimi duhet, këtu jam dakord me deputetin Hyseni, pasi pa pasur detyrimin nuk kemi garancinë që mekanizmi funksionon, por nuk mund të jetë vetëm detyrim, duhet patjetër të jetë akses për aplikim. Mekanizmi që sistemi të jetë i besueshëm duhet që sistemi të jetë i hapur dhe jo i mbyllur dhe kjo është shumë e rëndësishme për këtë gjë, në mënyrë që sistemi të jetë i besueshëm. Duhet patjetër të ketë mundësi për akses nga jashtë për këdo që e gjykon, e sheh apo ka interes,

sepse kjo lidhet me interesin, që të bëhet administrator zgjedhor, por në qoftë se ne e mbyllim, atëherë bëjmë gabim. Detyrimi është i domosdoshëm, sepse pa detyrimin nuk ka siguri që sistemi funksionon.

**Damian Gjikhuri** – Të gjithë ata që janë zyrtarë publikë kanë detyrimin të shkojnë të marrin certifikim.

**Ilir Rusmali** – Sa i takon pyetjes së fundit, që lidhet me dispozitat konkrete, ndoshta, vërejtja e deputetit Hyseni mund të jetë shumë e drejtë dhe ne duhet t’i shohim të gjitha dispozitat nga ky këndvështrim, por dispozita që u mor për ilustrim ka një keqkuptim, sepse dispozita nuk orientohet drejt detyrimit të personave dhe t’u thuhet: “U ndalohet personave”, por dispozita orientohet drejt detyrimit të KQZ-së, sepse është pikërisht KQZ-ja që harton listën e administratorëve dhe nuk mund ta fusë në listë këtë kategori.

Ne e kemi konsideruar që dispozita funksionon pa ndalim eksplicit, sepse për sa kohë ia kemi vënë këtë detyrë KQZ-së ajo do të bëjë filtrin, por në qoftë se i referohemi KQZ-së, dispozita me atë formulim është në rregull dhe jo me formulimin e ndalimit si ndalim.

Këto ishin përgjigjet tona për këtë pjesë.

**Damian Gjikhuri** – Po.

**Nimet Musaj** – Faleminderit!

Bashkëkryetarë,

Të nderuar kolegë,

Dua të vlerësoj punën që kanë bërë ekspertët që janë të pranishëm. Nga eksperiencia që kam gjithë këto vite, duke qenë disa herë në terren si kandidat, jam përfshirë pothuajse në masën absolute të të gjitha problematikave dhe mendoj se ka disa pjesë teknike që duhen parë. Edhe unë, që e vlerësoj këtë draft maksimalisht, kam disa pyetje, të cilat do t’jua bëj gjatë kësaj jave, si dhe jam dakord me kolegët që në ditët në vazhdim t’i bëjmë pyetjet tona dhe ekspertët të vijnë me përgjigje zyrtare për secilin nga anëtarët e komisionit, ndoshta këto të jenë të grumbulluara, pasi anëtarët mund të kenë bërë të njëjtën pyetje, dhe të jenë të përcaktuara saktë dhe të qartë. Të gjithë kolegët, që janë të pranishëm këtu, sidomos ata që nuk kanë pasur mundësi për ta parë këtë draft, pasi koha ka qenë shumë e ngushtë, ta shohin dhe në ditët në vazhdim dhe të mblidhemi për t’i parë.

Unë e vlerësoj këtë draft si një nga punët më të mira që është bërë gjatë gjithë këtyre viteve, pasi në të janë të reflektuar penalitetet, financimet, mënyrat e daljes nga situata, si dhe detyrimin ligjor që kanë të gjithë punonjësit e administratës për t’u bërë pjesë e këtij sistemi.

Nuk shoh asgjë mangët apo ndonjë moment që të lërë dyshime që mbrapa kësaj fshihet diçka tjetër.

Dua t'i falënderoj të gjithë ata që dhanë përgjigjet e tyre për këtë draft. Propozoj që në mbledhjen e ardhshme të bëjmë një takim vetëm për këtë draft dhe më pas të kalojmë në fazën e dytë, në procesin tjetër, për të cilën u shprehën ekspertët dhe specialistët.

Faleminderit!

**Damian Gjikhuri.** Fjalën e ka zonja Hysi, për pyetje.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë kam disa pyetje, por përgjigjet nuk i dua sot, për të fituar edhe kohë.

Falënderoj ekspertët për materialin e paraqitur. Megjithëse koha ishte e shkurtër, arrita që materialin vetëm ta lexoj, por jo ta studioj në detaje dhe në këtë kuadër dua të theksoj që krahas pyetjeve që do të bëj sot dhe në varësi të përgjigjeve që do të marr në seancën tjetër të kem të drejtë të bëj pyetje më të detajuara nëse është e nevojshme.

E para, më bie në sy një ndërhyrje në përbërjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke bërë një ndarje në 3 nëngrupe dhe automatikisht shoh një rritje të numrit të anëtarëve të komisionit në 9 anëtarë. Cili është modeli i përzgjedhur? A ka ndonjë model që e rregullon komisionin ose institucionin që administron zgjedhjet në formën që ju na keni paraqitur?

E dyta, kam një pyetje lidhur me kompetencat që i keni vënë komisionerit, por edhe Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve dhe Komisionit Rregullator. Nuk e kam për mandatin, pasi ju e dhatë përgjigjen, por nuk shoh, ndoshta e kam gabim dhe nuk jam në gjendje ta kuptoj: kush do t'i certifikojë zgjedhjet?

Te kompetencat flitet për komisionerin shtetëror dhe rezultatin final. Ju përmendni kompetencat dhe në të flitet për kompetencat e komisionerit, e Komisionit Rregullator dhe Komisionin e Ankimeve dhe të Sanksioneve, por nuk po e gjej, ndoshta nuk ma shohin sytë.

Më bën përshtypje tek administrata zgjedhore, që përveç ndryshimit të terminologjisë për KZAZ-të, keni folur për një emërtim tjetër, ku flitet për përbërjen dhe ngritjen e Njësisë së Administrimit të Zgjedhjeve dhe e keni bërë me 6 anëtarë. A jam e saktë?

Pra, 4 anëtarë dhe 2 sekretare. Më vjen mirë që jeni përpjekur për të pasur shortin dhe barazinë gjinore, por nga diskutimet që kemi bërë vazhdimisht, duke pasur edhe përvojën tonë si deputetë, mendoj se përbërjet kaq të mëdha në numër nuk sjellin ndonjë risi në reduktimin e asaj që ne, të gjithë deputetë dhe ish-deputetë e kemi merak, kostot administrative të administratës zgjedhore. Nga ana tjetër edhe në mbledhjen e kaluar folëm se do të ndërhyjmë në ligjin e financimit të partive politike, pra po shkojmë drejt kufizimit të

financimit të partive politike, drejt fushatave zgjedhore me sa më pak kosto. Në këtë kuadër, a ia vlen ta diskutojmë për të pasur një numër më të vogël të anëtarëve të njësisve të administrimit të zgjedhjeve?

Pra, pavarësisht se ata nuk do të propozohen nga partitë, përsëri mendoj se ka vlerë me buxhetet dhe varfërinë që kemi, fakti që anëtarët nuk do të propozohen më nga partitë, ky numër duhet parë.

E treta, më bën përshtypje propozimi për njësinë e administrimit të qendrës së votimit, përsëri 6 anëtarë. Nuk shoh ndonjë reduktim apo ulje të numrit. Në nenin 36 ju thoni: “Njësia e administrimit të votimit formohet me përfaqësim të garantuar nga 3 zyrtarë mbikëqyrës dhe zyrtarë të qartësisimit...”. Dakord! Shoh që keni 3 zyrtarë, megjithatë besoj se terminologjia duhet të ndryshojë, nuk e di se çfarë nuk ka funksionuar me terminologjinë e mëparshme, pse duhet të themi zyrtari mbikëqyrës, zyrtari i qartësisimit të votuesve dhe zyrtari i procedura të votimit.

Gjithashtu, më bën përshtypje edhe njësia e administrimit të numërimit. Me aq sa kuptoj, ju keni qëndruar te numërimi i përqendruar, jo në qendër votimi, por kjo njësi, më vjen mirë që ulet nga 4 në 2 zyrtarë zgjedhorë. Nuk e di nëse e keni parë edhe mundësinë për të pasur një numërim të votimit në qendër me qëllim për të marrë rezultat, duke pasur 2 persona. A keni ndonjë vlerësim të kohës që do t’i kushtohet numërimit të përqendruar të votimit për të pasur edhe një rezultat sa më të mirë, sepse këta bëjnë numërimin dhe tabulimin e rezultatit.

Kisha diçka lidhur me zyrtarët zgjedhorë. Kemi dy kategori zyrtarësh zgjedhorë, njëri që vjen nga shërbimi civil dhe tjetri që mund të jetë student e të tjerë. Jam shumë dakord që pa ndryshimet në ligjin për nëpunësit civil kjo gjë nuk do të ketë vlerë. Më ra sy kriteri që keni vënë për studentët, ku në një nga kriterit keni thënë që duhet të jetë student të paktën i vitit të fundit të ciklit të parë në Bachelor. Pse keni zbritur në këtë nivel? Keni ndonjë përlllogaritje që totali i punonjësve të nëpunësve civilë nuk është aq i mjaftueshëm sa të plotësojë gjithë ata zyrtarë zgjedhorë? Keni ndonjë orientim apo model nga vendet e tjera apo thjesht për të rritur pjesëmarrjen e të rinjve në administratën zgjedhore? Nëse për zyrtarët zgjedhorë, që vijnë me statusin e nëpunësit civil, ka sanksione dhe nëse nuk respektojnë ligjin humbasin edhe të drejtën, por për këta të rinj çfarë sanksionesh do të ketë? Në çfarë raporti do të jenë zyrtarët zgjedhorë që vijnë nga nëpunësit civilë me ata që janë studentë dhe nuk janë nëpunës civilë? Nëse e kam kuptuar saktë, sepse nuk ka nëpunës civilë që të mos ketë mbaruar masterin apo të paktën të kenë diplomën e Bachelorit.

Kam një pyetje të fundit lidhur me numërimin, teknologjinë dhe për votimin e emigrantëve. Ka shumë pak rregullime në materialin që ju keni depozituar dhe shoh që shumë gjëra i janë lënë pikërisht rregullatorit me akte nënligjore. Pra, këtu keni bërë më shumë një rregullim kuadër të përgjithshëm. Pse keni përzgjedhur këtë format? Cilat mund të ishin përparësitë, por edhe vështirësitë që mund të hasen nëse gjithçka do t'i lihet këtij komisioneri rregullator?

Faleminderit!

**Damian Gjinkuri** – Dua të bëj një sqarim të vogël. Nuk mendoj se duhet të bëjmë debat pse një qendër votimi dhe jo e përqendruar, ta lëmë këtë si pyetje, sepse kjo na takon neve, ndërsa për pjesën tjetër mund të vazhdoni.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Mendoj se nuk është momenti për ta diskutuar.

**Vasilika Hysi** – Nuk i dua përgjigjet sot, por në mbledhjen tjetër.

**Blerina Gjylameti** – Unë e kam për pjesën e sekretarëve për NJAZ-në, meqenëse janë 4 anëtarë dhe 2 sekretarë. Mos ndoshta mosndarja e detyrave dhe e përgjegjësisë ndërmjet 2 sekretarëve a mund të krijojë probleme? Si e keni menduar të zgjidhet problemi i lënies së përgjegjësisë nga njëri apo nga tjetri? Pse 2 sekretarë dhe jo 1 siç ka qenë më parë?

Faleminderit!

**Ilir Rusmali** – Faleminderit!

Mendoj se këto çështje janë të rëndësishme për të sqaruar edhe arsyetimet që kemi pasur në pas formulimeve që kemi përzgjedhur. Formalisht KQZ-ja në një farë mënyre disintegrohet, sepse ndahet në 3 pjesë, por si numër rritet, është mëse i vërtetë konstatimi i deputetes Hysi, por nga ana tjetër modifikimi nuk mbyllet këtu. Dy strukturat kolektive që mbahen janë struktura që nuk janë permanente, janë struktura që mblidhen sa herë kanë nevojë për to për të punuar. Pra, është një ndryshim rrënjësor nga formulimi aktual. Në vetvete rritja e numrit nuk është automatikisht rritje e numrit, sepse këta do të punojnë eventualisht 3 muaj dhe jo më shumë se aq në vit...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Mund ta shohim pa problem, mund të ketë ndonjë lapsus aty.

Pse në këtë formë, pse një organ monokratik që drejton administratën dhe dy organe kolegjiale që bëjnë këtë punë dhe me këtë numër anëtarësh? Ne jemi nisur nga rrethi i kompetencave që do të ushtrojnë dhe çfarë është tipike në varësi nga rrethi i kompetencave që ata do të ushtrojnë. Të gjitha kompetencat e komisionerit janë kompetenca tipike të një



organi monokratik dhe vuajnë, vështirësohen dhe mund të dështojnë në qoftë se jepen që t'i ushtrojë një organ kolegjal dhe anasjelltas. Të gjitha kompetencat e organeve kolegjiale në varësi nga fusha që kanë janë të panatyrshme për organin monokratik ose edhe nëse ushtrohen kanë një potencial rreziku për padrejtësi. Në qoftë se i lihet komisionerit të gjykojë mbi ankimet, sigurisht ka organe monokratike që gjykojnë mbi ankimet, por në fushën e zgjedhjeve nëse ia lëmë komisionerit rrisim rrezikun që padrejtësia në gjykim të na prishë zgjedhjet.

A ka modele për këtë? Në vetvete duhet ta themi, nëse e shohim nga ky këndvështrim, nga këndvështrimi i raportit midis mënyrës sesi formohet organi me kompetencat që ka, të gjitha modelet e botës janë të tilla 100%. E thënë nga një këndvështrim tjetër, modeli shqiptar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, organ permanent, ka qenë model që dilte për herë të parë në historinë e botës si i tillë. Kush ka marrë pjesë në krijimin e këtij modeli ndoshta ka bërë gabimin e jetës së vet, por është për herë të parë në historinë e botës. Që nga dita që është krijuar si i tillë dhe deri më sot ka treguar që ose nuk funksionon si duhet, ose funksionon jashtëzakonisht keq dhe me pasoja të rënda, por për fatin e keq të Shqipërisë dhe të shqiptarëve ky model është replikuar në Shqipëri dhe ka institucione të tjera të pavarura, borde drejtuese, që janë permanente dhe që sot e kësaj dite funksionojnë po aq keq ndoshta akoma më keq sesa funksionon Komisioni Qendror i Zgjedhjeve sot. Një pjesë të këtyre bordeve parlamenti edhe i ka shpërruar për këtë shkak, organe kolegjiale që duhej të bënin detyra tipike të një organi monokratik dhe që nuk kanë funksionuar, kanë bllokuar njëri-tjetrin, kanë turpëruar dinjitetin institucional në Shqipëri deri sa janë përzënë nga parlamenti dhe u është ndërruar formati institucionit.

Komisioni i Shërbimit Civil, ka qenë një nga këta shembuj, por nuk është i vetmi. Ju që keni të drejtën dhe detyrimin t'i mbikëqyrni institucionet e pavarura viheni herë pas here përpara situatave që institucionet e pavarura bllokohen në veprimtarinë e tyre, nuk funksionojnë. Ne, duke u nisur nga kjo eksperiencë dhe nga ky lloj arsytimi kemi thënë jo. Është e rëndësishme të ndahen kompetencat me thikë nga njëri-tjetri dhe në varësi nga kompetencat të ndërtohet struktura. Për këto arsye kemi thënë që drejtimi institucional i përket komisionerit, organ monokratik, titullarit të institucionit, ndërkohë që kompetencat specifike normative dhe ankimore t'i përkasim dy trupave që janë kolegjiale.

Ne kemi diskutuar gjatë për mënyrën se si duhej të formohej NJAZ-i. Edhe ne kemi qenë partizanë të reduktimit të numrit të administratës dhe e kemi konsideruar si një zhvillim të rëndësishëm për administratën e re reduktimin e numrit. Jemi nisur në arsyetimin tonë nga

logjika jo se sa interesa do të kënaqim me numrin, por se sa njerëz do të duhen për të bërë punën dhe kemi shkuar te numri 3 i domosdoshëm i anëtarëve të NJAS-it (zyrtarëve zgjedhorë) dhe te numri 2 i domosdoshëm i zyrtarëve zgjedhorë të NJAS-it, por ne besojmë, mendojmë dhe, pastaj ju e gjykoni, që numri 6 për NJAS-in është numri i nevojshëm për ushtrimin e funksioneve të veta.

Po të kemi në vëmendje rrethin e kompetencave që ka NJAS-i, ky i fundit punon fort në dy momente të veprimtarisë së tij: në momentin kur regjistron subjektet zgjedhore, kandidatët, atje ku e ka kompetencën për t'u regjistruar dhe në momentin kur mbikëqyr procedurat e numërimit të votave. Ndërsa në pjesën tjetër, NJAS-i është pothuajse pa kompetenca, domethënë ata mund t'i nxjerrin punë vetes, të shkojnë të inspektojnë, të bëjnë e ku di unë me radhë, por nuk kanë kompetenca që zënë volum kohe, që i zënë kohë. Në këto dy momente ata janë të detyruar të punojnë me turne.

Tani, ne kemi arritur në përfundimin se ka ardhur momenti në Shqipëri, logjika e kërkon që të respektohet orari normal i punës si për çdo trupë tjetër dhe orari normal i punës është tetë orë. Domethënë, ky mund të jetë një aksion i rëndësishëm në demokraci, por orari normal i punës duhet të jetë tetë orë. Prandaj kemi thënë: gjashtë veta që, kurdo kur kanë punë me kohë të zgjatuar, të alternojnë njëri-tjetrin tetë orë. Dy anëtarë dhe një sekretar punojnë si trupë, kryejnë detyrat e NJAS-it për tetë orë, pastaj këta marrin pushim, vjen trupa tjetër dhe procesi ecën në vazhdimësi pa ndërprerje.

Shkaku kryesor i vonesave që kemi ne në numërimin e votave, zhbllokimi i procesit për shkak të pamundësisë së KZAZ-së për të ushtruar funksionin, nuk duhet të jetë. Domethënë, KZAZ-ja duhet të funksionojë në mënyrë të vazhdueshme, permanente, derisa të mbyllë detyrën dhe nuk mund të ketë ndërprerje të procesit të votimit (siç thotë ligji, në fakt, se procesi i votimit nuk duhet të jetë me ndërprerje). Ndërkohë, çfarë ndodh në praktikë? Ndërpritet. Pse? Sepse njerëzit duan të flenë gjumë dhe kërkesën e tyre biologjike për të fjetur gjumë nuk ka ligj që e kundërshton. Prandaj kemi menduar që të funksionojë me gjashtë, me logjikën që trupa përgjysmohet sa herë ka nevojë që të punojë me orare të zgjatura.

Tani është një pyetje shumë e rëndësishme për terminologjinë që ne përdorim për këto dhe është, në fakt, zonja Hysi, një pyetje, së cilës do t'i përgjigjem pak më gjerë se sa e bëtë ju. Kërkesa para nesh ka qenë që të zgjidhnim një administratë zgjedhore me një strukturë të re, me një arkitekturë të re, si të thuash, të hapnim një kapitull të ri në administrimin e zgjedhjeve. Ne besojmë që është e domosdoshme për këtë fazë të demokracisë në Shqipëri,

për këtë zhvillim të demokracisë në Shqipëri, që kapitulli i ri të shoqërohet me terminologji të re. Ne po mbyllim një eksperiencë, të mirë apo të keqe gjykojeni si të doni, por po e mbyllim këtë kapak. Duhet që të gjithë shqiptarët të kuptojnë me çdo qelizë të tyre se është hapur një kapitull i ri dhe shqiptarët, që nuk janë ekspertë juridikë, as profesorë të së drejtës, as janë njerëz që hanë bukë përditë me lexim a shkrim ligjesh, e kapin ndryshimin nga terminologjia.

Në dëshirën tonë më të mirë ka qenë që edhe termi “KQZ” të hiqej dhe të gjendej një term tjetër, por kuadri i detyrës që kishim ishte i tillë që nuk na e lejonte, sepse, po të heqim termin “KQZ”, do të heqim të gjithë ligjin, por ne nuk e heqim dot të gjithë ligjin sot për sot, se na është thënë që do ta amendojmë, jo që do ta heqim. Prandaj e kemi mbajtur “KQZ”-në si terminologji dhe kemi ndryshuar gjithçka tjetër që vinte poshtë saj. Madje ju rekomandojmë me forcë që terminologjia e re të pranohet si e tillë nga ju, pasi është vërtet një sinjal drejtuar qytetarëve të këtij vendi që tani e mbrapa fenomenet e vjetra janë mbyllur, kanë dalë struktura të reja, me mënyrë sjelljeje të re, me kulturë të re dhe me përgjegjësi të re. Pikërisht këtë gjë, në mënyrën më të thjeshtë, për njerëzit e zakonshëm e jep terminologjia.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kam një pyetje, nëpërmjet së cilës dua të ndaj një konsideratë me anëtarët. Ju, po na e mbyllët gojën, na e mbyllni, por është vërtet me rëndësi të ndajmë një konsideratë për këtë pyetje, sepse duket sikur ne jemi kundër numërimit në qendrën e votimit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, është radha e pyetjes, por kryetari më tha...

**Damian Gjikhuri** – Unë thashë që nuk duhet të hysh te kjo, meqenëse...

Jo, kjo është një çështje tjetër, të cilën duhet ta diskutojmë ndërmjet nesh.

Është koha që mund të shkojmë në atë drejtim? Patjetër që pastaj...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Megjithatë, jepen një mendim.

**Ilir Rusmali** – Shikoni, ka një gjë. Për fat të keq, Shqipëria ka një eksperiencë therëse me numërimin në qendrat e votimit, dhe këtë po e them në parantezë. Kjo do të thotë që, në qoftë se kthehemi sot te numërimi në qendrat e votimit, pa e konsoliduar administratën e re, pa e vënë në provë administratën e re, pa parë që kjo funksionon dhe nuk na dështon si tjetra, ne rrezikojmë shumë në qoftë se e bëjmë veprimin sot, sepse jemi ende... Duhet vënë gjëja në provë, që mos të kthehemi tek eksperiencia therëse, e para.

E dyta, numërimi i përqendruar ka ende rezerva nëse do të ketë sukses. Ju ndoshta nuk jeni të vetëdijshëm, sepse nuk keni nevojë ta ndiqni çdo gjë, por, nisur nga një statistikë

nga zgjedhjet e fundit parlamentare, gati 95% e votave në rang Shqipërie janë numëruar brenda 24-orëshit të parë pas votimit; brenda një dite, 95%. Shqipëria në zgjedhjet e fundit parlamentare vuajti për këtë 5%-shin, që u bllokua, që u vonua; vuajti për shkak të lojës së zakonshme që bëhet me administrimin, por 95% e votave brenda këtij 24-orëshi të parë është arritje që, po ta kultivojmë, po ta ndihmojmë, po të shtojmë vendet e numërimit, sepse kemi reduktuar numrin e numëruesve, ne edhe mund ta përmirësojmë si afat dhe ende ka potencial.

Në qoftë ne shkojmë pastaj dhe e thellojmë diku në drejtime të tjera, e përmirësimit të procedurave, ku ka ende rezerva; e fillojmë eventualisht te ndryshimi i votave për qeverisjen vendore, ku jemi ende me dy vota, por, realisht, dy vota për kohën, ku jetojmë, janë të panevojshme për qeverisjen vendore. Cilido qoftë sistemi i qeverisjes vendore, dy vota janë të panevojshme. Pse duhen dy vota? Kur votat shprehin vullnetin, këtë të fundit e kalkulon pastaj mbi organin. Është gjë shumë e thjeshtë, por është çështje që ju takon juve ta shihni si potencial për reduktimin e kohës.

Tjetër çështje, jemi ende me alternativën e numërimit elektronik, më falni, të votimit dhe të numërimit elektronik (se është terminologji më e pasur), por votim elektronik, do të thotë edhe numërim në kohë reale.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, ne po themi këtë gjë që, në qoftë se kthehemi sot, mund të vihemi përballë një rreziku që mund të na dëmtojë për nesër, sepse mund të na prishë strukturën e administratës, mund të na e paragjykojë atë, mund të na e dëmtojë atë. Pra, ndoshta duhet menduar më thellë sesa me një të rënë të lapsit. Kaq po themi ne, ndërkohë që potencialet që ka mekanizmi aktual janë të mëdha: rritet numri i numëruesve, por mund të rritet edhe numri i vendeve të numërimit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk janë 66, më duket se janë 91.

Pra, ka ende potencial për ta përmirësuar procesin e numërimit sot.

Nga ana tjetër, në qoftë se do të implementohet teknologjia, bie debati për numërimin, sepse teknologjia e nxjerr rezultatin në sekondën kur mbyllet procesi i votimit. Ka dalë në rang kombëtar rezultati. Pra, ka ende alternativa për t'u eksploruar dhe ne sugjerojmë: eksplorojini alternativat para se të merrni vendimin. Pastaj, në qoftë se ju gjykoni që alternativat nuk kanë vlerë dhe ne duam në zgjedhjet e ardhshme që numërimi të bëhet në qendrat e votimit, ne e bëjmë, sepse është shumë i lidhur me procedurat dhe nuk ka asnjë vështirësi serioze.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Studentët dhe raporti i tyre me administrimin e zgjedhjeve

Ne kemi pasur një pikësynim, kur i kemi përfshirë studentët: ndërgjegjësimin e kontingjentit të vazhdimësisë së administratorëve të ardhshëm zgjedhorë me interesin që ata kanë për t'u bërë administratorë zgjedhorë. Çfarë ndodh sot? Po t'i pyesësh studentët sot, dinë gjithçka për studimet master në Zelandën e Re, në Australi ose në Kinë. Pse? Sepse kanë një interes material, interesin e tyre privat për të marrë vesh si mund ta zhvillojnë CV-në për të garantuar një punësim më të mirë nesër.

Duke i konfrontuar në bankat e shkollës me interesin që kanë për t'u bërë administratorë zgjedhorë, ne i ndihmojmë ata për t'i parë më mirë alternativat e tyre për të ardhmen, ndërkohë që ndihmojmë edhe sistemin e administrimit për të marrë gjak të ri në vazhdimësi, sepse sistemi ka nevojë të mbushet me gjak të ri në mënyrë permanente. Prandaj kemi thënë që duhet t'u jepet e drejta studentëve për të... Pse niveli Bachelor. Kjo është konsideratë, po themi, oportuniteti. Ju gjykojeni si të doni, por, në qoftë se pyetem unë, si të thuash, se si e gjykoj unë personalisht këtë gjë, për mua kriter themelor është mosha 18 vjeç dhe jo mosha 21 vjeç, sado që ka mendime se mosha 21 vjeç është një pjekuri më e madhe për njeriun dhe ndoshta është mirë të jetë 21 vjeç. E rëndësishme është që njeriu, gjatë kohës që është student, të jetë i vetëdijshëm për faktin që do të mund t'i duhet në jetë që të bëhet administrator zgjedhor.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në rregull.

Për sa u përket teknologjisë dhe emigrantëve, janë pak dispozita, sepse ne, si të thuash, kemi zbatuar një kriter bazë në të gjitha amendamentet që kemi bërë. Ne kemi konstatuar, por nuk jemi vetëm ne, besoj se edhe ky komision ka konstatuar që, me kalimin e kohës, Kodi Zgjedhor në Shqipëri ka marrë përmasat e një, po e quaj kështu unë, monstre. Kodi Zgjedhor është bërë i madh, shumë i detajuar, shumë i komplikuar dhe shumë i vështirë për t'u menaxhuar si tekst ligjor. Jo vetëm kaq, por dokumentacioni ligjor për zgjedhjet në Shqipëri (ju e keni pasur gjithmonë nëpër duar) është vuajtje ta shfletosh, sepse të njëjtat dispozita janë te Kodi Zgjedhor, sidomos për procedurat; të njëjtat dispozita janë te rregulloret, të njëjtat dispozita janë te manualët dhe po të njëjtat dispozita janë tek udhëzuesit, me ndryshime të vogla. Madje, duhet të lodhesh për të gjetur se ku është ndryshimi, ku është e reja te njëra apo tek tjetra. Pse ka ardhur kjo? Kjo ka ardhur si rezultat i nevojës që kanë

pasur gjithmonë negociatorët të merrnin garanci mbi garanci të ligji që t'i kishin procedurat me detaje në ligj, gjë që e ka denaturuar ligjin.

Detajet procedurale, si rregull, nuk janë të ligjit, por, nga ana e teknikës legjislative shqiptare, u përkasin akteve nënligjore.

Çfarë është e domosdoshme për ligjin? Ligji ka nevojë për kompetencat dhe garancitë. Këto të fundit nuk t'i jep dot akti nënligjor. Garancitë nuk është mirë t'i japë akti nënligjor, sepse në Shqipëri ka edhe raste kur i jep akti nënligjor, nuk është fort e drejtë, por është histori tjetër. Pra, garancitë duhen në ligj, jo në aktet nënligjore.

Në arsyetimet tona për teknologjinë dhe votimet nga jashtë vendit ne kemi ndjekur parimin që garancitë të jenë në ligj, ndërsa procedurat tek aktet nënligjore. Në qoftë se do të kemi rastin që ta trajtojmë temën edhe kur të vijë procedurat, këtë gjë do t'ju prezantojmë. Ndoshta ne nuk i kemi hartuar ende, por draftet tona për procedurat do të jenë të tilla: do të jenë më pak sesa drafti aktual, do të jenë më të koncentruara dhe do të jenë kryesisht garanci, jo procedura. Ky është propozimi që do t'ju sjellim ne. Pastaj, e pranoni ose jo, është çështje tjetër, por në logjikën tonë Kodi duhet të përmirësohet edhe në këtë sens. Duhet të thjeshtohet, të bëhet më konciz, më i lexueshëm, më i qartë, më transparent dhe pjesa tjetër i kalon akteve nënligjore.

Për çështjen e dy sekretarëve ne kemi dhënë një formulim në kod për alternimin e veprimtarisë së sekretarëve dhe themi se gjëja funksionon. Nëse gjykoni se është e pamjaftueshme, vëmë edhe diçka më shumë se kaq, por ne besojmë se nuk do të ketë konflikt kompetence midis sekretarëve, sepse mendojmë se është mjaftueshëm e qartë.

Së dyti, gjithë procedura e KZAZ-së do të jetë në një akt nënligjor dhe akti nënligjor do të ketë mundësinë ta shtjellojë në detaje mënyrën si funksionon njëri dhe tjetri. Kështu që besojmë se nuk ka për të pasur vështirësi.

Faleminderit!

**Damian Gjikhuri** – Në fakt, që të mos përsërisim shumë, kam dy gjëra, se më tërhoqi vëmendjen ajo që tha Iliri. Këtë e dua edhe për rekord, pra kur bëhet fjalë për dilemën që kemi ne drejt numërimit të përqendruar apo numërimit në qendër votimi, unë them se është si çështja e ekuacionit me dy të panjohura. Ne po bëjmë një ekuacion me një të panjohur, që është depolitizimi i administratës.

Së dyti, për numërimin e përqendruar, pavarësisht nga pretendimi që ka njëri apo tjetri, asnjë nuk e vënë në dyshim integritetin e procesit. Është vënë në dyshim aspekti kohor.

Pra, integriteti, transparenca, nuk e ka vënë në dyshim... Këtu po bëhet fjalë për tregtinë mes kohës dhe integritetit.

Megjithatë, mendoj se integriteti dhe transparenca ndonjëherë janë më të rëndësishme se koha, se e panjohura e dytë, pra si do të sillen kur janë dy të panjohura. Mendoj se mund të sjellë shumë probleme të tjera.

Megjithatë, që të mos i hymë, se ky është një diskrecion politik, që mund ta vendosë vetë komisioni, mendoj se duhet pasur edhe kjo parasysh, edhe nga ekspertët, edhe nga vetë ne me njëri-tjetrin.

Kam për të bërë edhe një sqarim, që e tha pak edhe Iliri, me sa e kuptoj unë hapjen, edhe për njëri-tjetrin këtu. Pse nuk është bërë vetëm në administratën publike? Se detyrimi është që gjithë administrata shtetërore, që gëzon statusin e nëpunësit, do të shkojë në një proces trajnimi, por dikush do të thoshte, siç e ngriti dhe Ralfi më parë: “Prit, se administrata, në përgjithësi, janë njerëzit tuaj. I keni futur ju në punë”.

Hapja e këtij procesi, pra që hyjnë edhe kandidatë të tjerë dhe në fund të fundit përzgjedhja e tyre bëhet me short, jep garancinë që ky proces të mos jetë i kontrolluar apo i instrumentalizuar nga njëra palë. Pra, kjo do të thotë se është e hapur, mund të hyjnë studentët e vitit të katërt dhe çdo njeri tjetër që pretendon se ka një arsim të lartë dhe pretendon nesër të punojë në administratën shtetërore. Pra, kjo është një detyrë dhe një kërkesë paraprake për çdo lloj rruge karrierë që ai do të marrë në të ardhmen.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, pra. Shkelja të penalizon që nesër ti të mos hysh më në këtë administratë. Duhet ta kuptojmë pak se pse bëhet kjo.

Edhe unë thjesht mund të thosha vetëm një grupim i caktuar, vetëm administrata, por patjetër do të paragjykohehin. Në kushtet e Shqipërisë do të kishte një lloj paragjykimi.

Pastaj, për çështjen nëse ka nevojë për rregullime, edhe unë kam shumë vërejtje dhe gjëra të tjera, që ne duhet t'i diskutojmë me njëri-tjetrin, sidomos KQZ-ja duhet ta shprehë në mënyrë eksplicite si do të funksionojë roli i ndarjes, rrotacioni i komisionit në zonën zgjedhore apo NJAZ-të, siç i quajmë tashmë. Këto janë gjëra që duhet të dalin qartë, që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të saktësojë mirë pjesën rregullatore.

Megjithatë, vazhdojmë me pyetjet deri në orën 13:30. Më pas do të vazhdojmë seancën tjetër.

**Adriatik Alimadhi** – Faleminderit, zoti bashkëkryetar!

Ju kërkoj ndjesë për ngritjen e zërit, ndoshta i rashë edhe tavolinës! Kjo nuk është në karakterin tim, por duke qenë pjesë e këtij komisioni, kam dashur...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

...që në të gjitha komisionet ku marr pjesë të jap kontributin tim, sido qofshin ato.

Megjithatë, kam një konsideratë për zotin Rusmali. I kërkoj ndjesë, sepse herën e parë dola nga mbledhja e komisionit, duke i thënë se ka qenë bashkëkryetar me zotin Islami...!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po ta them unë, nuk ka problem.

Të kërkoj ndjesë, sepse prej atij kodi ne si subjekt politik kemi vuajtur!

Pavarësisht se shumë nga kolegët i prekën çështjet (ata kanë qenë edhe pjesëmarrës në proceset zgjedhore), duke qenë edhe vetë pjesë, si subjekt, mendoj se është mirë të diskutojmë 2-3 pyetje.

Në nenin 13 kanë të drejtë të kandidojnë ose të propozohen për komisionerë shtetasit shqiptarë që vijnë nga radhët e ish-funksionarëve politikë, sepse gjatë gjithë kohës ju lançuat “sa më larg, të depolitizohemi”... Çfarë keni parasysh këtu? Sepse neve na është bërë gangrenë kjo pjesë dhe po të shohësh, në të gjitha komisionet që ne kemi vajtur apo në grupet e numërimit, nuk kanë pyetur më për ne, sepse nuk na kanë dashur të ishim pranë grupeve të numërimit.

A mos është nevoja ta heqim këtë pjesë dhe ta bëjmë sa më të pavarur? Pra, të mos jenë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

KQZ-në po them unë.

Po i bëj pyetjet një nga një, që të marr përgjigje.

**Ilir Rusmali** – Ndjesë! Nuk e kuptova.

Funksionarët politikë janë kategori juridike, që vjen nga ligji për shërbimin civil, që nga ‘96-ta dhe është ende sot në fuqi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dakord.

Edhe unë dua t’i përgjigjem me shumë qetësi dhe dashamirësi pyetjes. Nuk dua të përsëris arsyetimin që termi politik që nënkuptojmë ne ka lidhje me partitë politike, pra raporti i drejtpërdrejtë me partinë politike e bën strukturën politike.



Termi “funksionar politik” është term juridik i atij ligji, që nuk do të thotë “politikanët”. Ai ligj është ende në fuqi. Pra, kapitulli i ligjit për shërbimin civil për funksionarët politikë është ende në fuqi. Në gjuhë të thjeshtë, do të thotë të gjithë anëtarët e kabineteve të titullarëve të institucioneve të këtij vendi. Këshilltarët janë funksionarë politikë. Këshilltarët, si rregull, janë në gjen teknikienë. Ata nuk janë politikanë. Këshilltarët janë teknikienë dhe si rregull janë kapacitete të larta intelektuale për fushën e tyre. Kjo është logjika e gjësë.

Po, është e vërtetë, te funksionarët politikë bëjnë pjesë edhe deputetët, se janë funksionarë politikë, siç janë edhe anëtarët e qeverisë. Ata bëjnë pjesë aty, siç është Kryeministri, Presidenti, por të mos e çojmë deri atje, se nuk kanë për t’u bërë kurrë komisionerë.

Cili është arsyetimi ynë? A është në logjikën e këtij vendi që kapacitetet më të larta tekniko-profesionale t’i angazhojë në këtë proces demokracie?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të flasim pak për interesin. Interesi i këtij vendi është që kapacitetet më të larta tekniko-profesionale t’i angazhojë për këtë qëllim.

Pse thamë që në fillim se kriteri nuk duhet parë në gjysmën e vet? Në radhët e funksionarëve politikë ka lista me njerëz të padenjë, ka lista me njerëz që eventualisht mund të jenë përballur me drejtësinë, ka lista me njerëz që kanë neglizhuar respektimin e ligjit, që kanë bërë thyerje të ligjit, kanë bërë arbitraritete në jetën e tyre të mëparshme. Ne nuk po kërkojmë të përzgjidhen këta dhe të bëhen komisionerë. Ne po kërkojmë që në këtë kategori kaq të madhe, që nuk është numër i vogël (jo 20 vetë, siç tha kolegu juaj, por me mijëra) ju që e keni në dorë, të përzgjidhni më të mirët, njerëzit me CV të certifikuar dhe me reputacion të lartë. Pra, ne nuk po kërkojmë funksionarët politikë, por po kërkojmë në këtë kategori ata që janë më të mirët dhe po i themi parlamenti se nuk mund ta përzgjedhë kryetari i grupit parlamentar.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Prit, të lutem!

Ne e kemi çuar aty ku nuk ka pasur eksperiencë ky parlament më parë, në të drejtën e çdo deputeti për të avancuar kandidatura. Pastaj është deputeti ai që e gjykon: “Unë kam këtë kandidat dhe dal para shqiptarëve garant për këtë figurë” dhe kur të bëhet përzgjedhja dhe parlamenti me votë midis 10,20,30 kandidatëve do të zgjedhë më të keqin, shqiptarët do të kuptojnë pse ndodhi kjo. Në qoftë se do të zgjedhë më të mirin, do t’i thonë hallall atij që e ka

propozuar, por nuk do të ketë mekanizma artificialë, që bllokojnë avancimin e kandidaturës së mirë. Mekanizma që bllokojnë avancimin e kandidaturës së keqe ka. Mund të mos ia arrijë 100%, sepse maxhoranca është maxhorancë dhe voton, por mekanizma që bllokojnë kandidaturën e mirë, ky nuk ka. Kjo do të thotë se ka një stimul, një garë midis deputetëve për të zgjedhur figura me reputacion, për t'i çuar para dhe për t'u dal edhe zot atyre figurave.

Kjo është e reja që sjell ky mekanizëm, e ndryshme nga të gjithë mekanizmat e tjerë që, në një farë mënyrë, kamuflojnë daljen zot të kandidaturave.

Në traditën e politikës shqiptare, sidomos parlamentare, është gjithmonë kështu, na vijnë kandidaturat që nuk janë të përshtatshme nga një strukturë tjetër, gjejmë gjithmonë një OJF, që na sjell një kandidat që nuk është i përshtatshëm dhe themi: “Çfarë t’i bëjmë ne?! E solli OJF-ja”.

Ne e kemi refuzuar këtë praktikë dhe themi: “Jo, çdo deputet ka të drejtën të avancojë, sikurse ka edhe përgjegjësinë morale, unë them edhe politike (por unë nuk e keqkuptoj fjalën “politike”), para shqiptarëve për të zgjedhur kandidatura të mira dhe përgjigjet para popullit të vet, i del zot kandidaturës së vet.”

Nuk ka mekanizëm më të mirë dhe me më garanci për sukses se ky.

Konkurrenca midis më të mirëve është zgjidhja më e mirë e mundshme, por të lutem, kriteri nuk është ish-funksionar politik, nuk është ish-gjyqtar, nuk është ish-nëpunës i lartë. Kriteri janë këta, por me këtë kusht.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Damian Gjikhuri** – E lamë në 13:30, ra gongu dhe nuk kemi mbaruar.

Tani, për procedurë, të vendosim një... Deri ditën e hënë çdo pyetje të bëhet në sektari, me *e-mail*, me të gjitha format, si ta mendoni ju. Uluni me ekspertë dhe të gjitha pyetjet t’i drejtohen sekretarisë deri ditën e hënë. Ditën e premte të javës tjetër ta lëmë në orën 09:00 dhe të fillojmë pak më herët.

A jeni dakord? Ditën e premte, javën tjetër, orarin po e themi përafërsisht 09:30 ose 10:00, do të fillojmë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk jam unë të enjten, ky është problemi.

Ditën e premte... Atëherë do të keni marrë edhe të gjitha pyetjet, Ilir, bashkë me Viktorin dhe ekspertët. Të vijnë të përgatitura me të gjitha përgjigjet.

Ndërkohë, kur të bëhen të gjitha pyetjet, t’u shpërndahen të gjithë deputetëve në mënyrë që të mos kemi përsëritje. Pyetjet mund të grupohen. Deputetë të ndryshëm mund të

kenë pyetje, që mund të jenë të njëjtat, por këto pyetje të qarkullojnë me *e-mail* tek të gjithë deputetët.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Do të vazhdojmë, se nuk mbaron kjo punë.

Ditën e premte kemi edhe një proces tjetër, për ata që janë të interesuar dhe mund të ftoni kë të doni. Do të bëhet një prezantim i një teknologjie për procesin e votimit elektronik. Është thjesht një demonstrim para komisionit dhe do të prezantohet nga një kompani ndërkombëtare, që e aplikon këtë në vendet që kanë sistem elektronik të votimit, për ta parë dhe për të drejtuar edhe ne pyetje, për ata që kanë interes. Pra, krahas kësaj seance do të zhvillohet edhe një proces tjetër të premtën, javën tjetër.

A jeni dakord?

Të bëhen të gjitha njoftimet, edhe për personat e interesuar.

Faleminderit shumë për pjesëmarrjen!

## **MBYLLET MBLEDHJA**